# GAZETA SHQIPTARE

Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXVI - Nr. 7798 E mërkurë 20 Shkurt 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)










Intervista e Ditës

Nga VETON SURROI

## Uzurpimi i pavarësisë



Për shumicën e madhe të qytetarëve, shteti i Kosovës është shndërruar në një aforizëm për media sociale, aty ku shumica e popullatës së vendit ... Vijon në faqet 20-21

Dje në "Deutsche Welle"

Nga ANI RUCI

## Opozita, pse i djeg mandatet dhe kërkon zgjedhje të parakohshme



Opozita në Shqipëri kërkoi të hënën (18.02.2019) largimin e kryeministrit Edi Rama dhe zgjedhje të parakohshme parlamentare. Kërkesa erdhi menjëherë ... Vijon në faqen 21



Hedhja e dherave, 100 euro më shumë për kamion

# Aferë në landfillin e Sharrës, caktohen tarifa shtesë nga koncesionari privat

Tarifën do ta paguajnë edhe individët. "News 24": Bashkia e Tiranës ka pranuar propozimin e firmës

Për të hedhur mbetjet inerte në landfillin e Sharrës, kompani të ndryshme ndërtimi, kanë kontraktuar kamionë për të realizimin e këtij procesi. Ndërkohë, ashtu siç dihet, ky landfill është i vetmi vend në të gjithë kryeqytetin ku lejohet hedhja e dherave, apo materialeve që mbeten pas ndërtimeve. Kompanitë duhet të paguajnë një shumë prej 480 lekësh për ...

Në faqen 17

QENDRIMI I FORTE I AMBASADES: REFUZONI THIRRJET PER BRAKTISJE TE KUVENDIT

# SHBA: DJEGIA E MANDATEVE, PD-LSI MINOJNE DEMOKRACINE

Opozita nuk tërhiqet, të enjten dorëzohet dosja me deklaratat individuale. Basha: Nuk tërhiqemi. Rama: Film i parë sa herë afrohen zgjedhjet







*(Në foto)* Protesta e 16 shkurtit para Kryeministrisë. Ambasada amerikane në Tiranë. Kryetari i PD Lulzim Basha, duke folur për mediat

Në faqet 2-3

DOKUMENTI

## Projekti, shkrihen 30 inspektorate, qindra punonjës rrezikojnë vendin

Në faqen 6

PERMET

## U denoncua si i zhdukur 2 javë më parë, gjendet i vrarë 32-vjeçari

Në faqen 7

VLORE

## Masakra me 8 të vrarë, prokuroria kërkon burg përjetë për Ridvan Zykajn

Në faqen 8

PERKUJTIMI

## Rrëfimet e të mbijetuarve, tek ish-shtatorja e Enver Hoxhës

Në faqen 18

EMRAT/ Ndërtimet pa leje, përfituesit e 'dëmshpërblimit' në Tiranë dhe në rrethe

# Kompensimi, 750 pronarët që ndajnë 5 milionë dollarë

*Formulari i aplikimit për përfitimin nga fondi financiar. 6 dokumentet që duhen dorëzuar*

Publikohet lista me 750 pronarë që do të marrin kompensimin e pronarëve që u është zënë toka nga ndërtimet pa leje. Fondi i vënë në dispozicion është rreth 552 milionë lekë. Bëhet fjalë për ndërtimet pa leje në drejtoritë për ALUIZNI-t, përkatësisht në Tiranë Veri, Elbasan, Tiranë Jug, Tiranë Shtesat, Vlorë, Durrës, Shkodër, Korçë, Kukës, Kavajë, fshatra turistike dhe Kamëz, Vorë. Referuar vendimit të Këshillit të Ministrave, vlera e kompensimit për 43 920,53 m2 është 522 842 426,65 lekë. ATP publikon edhe formularin që duhet



të plotësojnë përfituesit për të marrë kompensimin. "Gazeta Shqiptare" publikon listën me përfituesit në në gjithë vendin.Në vendim përcaktohet se për kompensimin e pronarëve përdoren po ato të ardhura që arkëtohen nga ...

Në faqet 10-12

# MANDATET
## OPOZITA

Djegia e mandateve, opozita dorëzon të enjten dosjen me deklaratat individuale të deputetëve

# Basha citon Linkolnin: Ky komb do të ketë një lindje të re

## "Nuk ka kthim pas për mandatet, të hetohet Rama"

Valentina Madani

Opozita pritet që të enjten në Kuvend dhe në KQZ të dorëzojë dosjen me deklaratat individuale të deputetëve, të cilët heqin dorë nga mandati. Vetë kreu i PD-së, Lulzim Basha, mohon çdo mundësi negocimi me Edi Ramën dhe çdo mundësi për t'u tërhequr nga vendimi për djegien e mandateve. Basha u shpreh i vendosur se nuk ka kthim prapa në vendimin për djegien e mandateve. Në një dalje për mediat, Basha tha dje se opozita do të jetë në krah të shqiptarëve. "Ajo që do ndodhë është që nuk ka kthim prapa, nuk është thjesht çështje mandatesh, nuk do ketë më parlament dhe për këtë nuk ka dhe nuk do të ketë asnjë negociatë", deklaroi z.Basha. Kreu i opozitës shprehet se vendit i duhet një qeveri transitore, për të përgatitur zgjedhjet e parakohshme dhe për të bërë drejtësi. Pas vendimit për lënien e mandateve, duket se Lulzim Basha, tashmë nuk kërkon vetëm qeveri transitore, por edhe burgosjen e zyrtarëve të PS-së që sipas tij janë kapur duke vjedhur vota. "E para, dorëheqja e Edi Ramës, largimi i Edi Ramës dhe hetimi i tij. Qeveria transitore duhet të mundësojë që të mos ketë asnjë ndërhyrje politike si ajo që bëri Edi Rama për të mbrojtur Vangjush Dakon. Damian Gjiknuri, Taulant Balla që ka vjedhur votat duhet të shkojnë në burg", deklaroi z.Basha. Kreu demokrat iu përgjigj edhe deklaratës së zëdhënëses së Komisionit Europian, Maja Koçijançiç, sipas së cilës vendimi i opozitës shqiptare për të bojkotuar parlamentin dhe djegur mandatet është kundërproduktiv dhe shkon kundër reformave që kërkon integrimi. "Pengesa kryesore e integrimit të Shqipërisë është qeveria e kapur duke vjedhur zgjedhjet, siç demonstron dosja '339'. Kur qeveria kapet duke vjedhur, në çdo vend të Europës ikën qeveria dhe fajtorët ndëshkohen para ligjit dhe hyjnë në burg. BE duhet të jetë e besueshme. Integrimin europian e pengon kapja e gjitha pushteteve, të cilat janë vetëm në dorën e një autokrati të korruptuar dhe të lidhur me krimin, -tha Basha.

**REAGIMI**

Kryesia e PD-së miratoi mbrëmë unanimisht propozimin e grupit parlamentar të për të hequr dorë nga mandatet në Kuvend. Ky vendim do t'i paraqitet sot për vendimmarrje finale Këshillit Kombëtar të PD-së. Pas mbledhjes, kreu i PD-së, Lulzim Basha, refuzoi të komentojë deklaratat e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila është shprehur kundër djegies së mandateve, por ai përmendi se për PD dhe atë vetë nuk ka frymëzim më të madh se SHBA dhe demokracia amerikane. Basha iu përgjigj ambasadës amerikane me një shprehje të presidentit Linkoln. "Nuk komentoj kurrë asnjë deklaratë të përfaqësive të huaja në Tiranë, por dua tua them qartë dhe shkoqur se për mua dhe PD nuk ka frymëzim më të madh se SHBA dhe demokracia amerikane. Në veçanti veçoj presidentin Linkoln dhe dua ta citoj: Shpresoj që kjo sakrificë nuk do shkojë kot, se ky komb nën zot do ketë lindje të re të lirisë dhe demokracisë. Qeverisja e njerëzve nga njerëzit për njerëzit nuk do të zhduket nga faqja e dheut. Nuk do të zhduket nga faqja e Shqipërisë! Zoti e bekoftë Shqipërinë! Zoti e bekoftë Amerikën", - tha Basha. Kreu i PD-së sqaroi se djegia e mandateve nuk është qëllim në vetvete, por rekursi i fundit që i është lënë opozitës për të arritur një qëllim madhor: shembja e një qeverie të krimit, për krimin dhe nga krimi dhe kthimi i një qeverie të njerëzve, nga njerëzit dhe për njerëzit. "Djegia e mandateve nuk është qëllim në vetvete, djegia e mandateve është rekursi i fundit që i është lënë opozitës për të arritur një qëllim madhor. Të shembim një qeveri të krimit, për krimin dhe nga krimi dhe t'u japim shqiptarëve një qeveri të njerëzve, nga njerëzit dhe për njerëzit. Për këtë, ne nuk po kërkojmë të marrim diçka, nuk po kërkojmë të marrim mandate me ndihmën e krimit të organizuar, siç ka bërë Edi Rama dhe siç është vërtetuar edhe nga provat gjyqësore të publikuara nga 'Zëri i Amerikës'. Ne po japim!", deklaroi z.Basha.


Kreu i PD-së, Lulzim Basha

**DEKLARATA**

"Në veçanti mes galerisë së personaliteteve që kanë dhënë kaq shumë vlerësoj presidentin Linkoln dhe dua ta citoj: 'Ky komb nën zot do të ketë një lindje të re të demokracisë dhe lirisë dhe se qeverisja e njerëzve nuk do të zhduket nga faqja e dheut, nga faqja e Shqipërisë", - tha z.Basha.

**VENDIMI**

Opozita pritet që të enjten në Kuvend të dorëzojë dosjen me deklarat individuale të deputetëve, të cilët heqin dorë nga mandati. Vetë kreu i PD-së, Lulzim Basha, mohon çdo mundësi negocimi me Edi Ramën dhe çdo mundësi për t'u tërhequr nga vendimi për djegien e mandateve.


Gjatë një seance parlamentare

Deputetët e PD-së: Vendimi, si në gjyqet e diktaturës

# Protesta e 16 shkurtit, lihet në burg Florenc Hoxha dhe 5 protestues

Gjykata e Tiranës la dje në burg 6 nga të arrestuarit për protestën e 16 shkurtit 2019 të thirrur nga opozita, 7 të tjerë u lanë në "arrest shtëpie" dhe 6 të tjerë në "detyrim paraqitje". "Arrest me burg" u dha për Florenc Hoxhën, Ilir Hamedanin, Resul Dacin, Sajmir Rexhepin, Agim Peposhin dhe Ferit Dankshin. Në "arrest shtëpie" u lanë Emanuel Nallbani, Naim Haxhiu, Andon Nasigjini, Festim Taku, Edjon Dine, Velion Tuci dhe David Linati. Ndërsa masa "detyrim paraqitje" u dha për Suzana Dimushin, Luftar Jakupin, Pëllumb Shelnën, Mitat Fierakun, Shpresa Linin dhe Hasan Jakupin. Prokuroria ngriti akuzën ndaj tyre për veprën penale të "kundërshtimit të punonjësit të policisë", "goditje për shkak të detyrës", "shkatërrim i pronës" dhe "prishje të rendit publik". Gjatë seancës së vlerësimit të masës së sigurisë, avokati i të arrestuarve, Ivi Kaso tha se prokuroria nuk kishte asnjë provë për ushtrim dhune. "Me përjashtim të një personi që ishte marrë gabimisht, të gjithë kanë qenë pjesëmarrës dhe e pranuan me krenari. U pretendua nga ana e tyre se nuk kanë kryer akte dhune qofshin ndaj policisë, qoftë ndaj pronës publike. Nuk ka asnjë provë që t'i lidhin këta me akte dhune. Organi i prokurorisë dështoi të sillte një provë të vetme apo një imazh që t'i lidhe me akte dhune. Prova nuk ka në asnjë nga fashikujt që solli prokuroria", deklaroi z.Kaso. Sipas tij, janë falsifikuar provat në rastin e ndalimit të Florenc Hoxhës dhe ai që ka bërë këtë do të mbajë përgjegjësi. Deputetët e PD-së, të pranishëm në seancën e djeshme, e cilësuan vendimin si në gjyqet komuniste. Kreu i grupit parlamentar të PD-së, Edmond Spaho, e quajti vendimin e gjykatës përpjekje për të dekurajuar protestën, por që nuk do të funksionojë. Ndërkohë që deputeti Alibeaj tha se Rama "duhej tërhequr zvarrë". "Ky është një proces i mirëfilltë politik, që më kujton gjyqet e diktaturës. Asnjë fakt dhe asnjë provë për atë që i akuzojnë, prishje të pronës publike dhe prishje të qetësisë publike. Ndërkohë që është prishur vetëm kërpudha e kryeministrit", tha z.Spaho.

**PROTESTUESIT**

Deputeti Salianji publikoi dje një video të protestuesve të arrestuar pas protestës së 16 shkurt për veprime të dhunshme. Të akuzuarit thërrasin "Rama ik" me dy gishtat lart brenda kafazit të xhamit. "Përshëndetje nga gjykata! Kudo, në këmbë për Shqipërinë", tha Salianji.





## Çika: Më shumë se 3 deputetë kanë qenë pjesë e Sigurimit

Shoqata Antikomuniste e të Përndjekurve kërkon më tepër transparencë për dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit për deputetët e parlamentit shqiptar. Deri më tani Autoriteti i Dosjeve thotë se më shumë se 3 deputetë kanë qenë pjesë e Sigurimit të Shtetit, ndërsa kreu i Shoqatës Antikomuniste, Nebil Çika tregon se ka më tepër. "Komisioni Bezhani, i cili ka pastruar figurat pas vitit 1997, i ka dhënë atij në shkelje të ligjit dhe ai rezulton i pastër edhe pse në dosje vërtetohet veprimtaria kriminale me Sigurimin e Shtetit", deklaroi z. Çika. Sipas tij, Autoriteti ka përjashtuar disa emra të përfshirë në sigurimin e shtetit në parlament. "Kemi të dhëna që është fshehur autori të krimeve të komunizmit. Kemi dy raste të vërtetuara, siç është kryetari i parlamentit, Gramoz Ruçi dhe deputeti Spartak Braho", u shpreh z.Çika. Kreu i Shoqatës Antikomuniste të të Përndjekurve thotë se gjendja me fshehjen e dosjeve të ish-Sigurimit të Shtetit është e rëndë dhe se duhet bërë edhe më tepër transparencë publike.

REDAKSIA: Redaktor i Suplementeve dhe Sociales: Rezarta Delisula, Redaktor i Rretheve: Tréndafile VISHA, Redaktor i Kulturës: Fatmira Nikolli, Art Designer: Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA: Përgjegjëse e Financës: Alma Smokthina 0682074397, Shpërndarja: Elvis Llaka Cel 0682074416, Marketingu: Cel:0682074415-email:marketing@gazetashqiptare.com, ADRESA: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 Marketingu: Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, Internet: www.balkanweb.com, Email: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, SHTYPUR në "Klasik"Shpk



## Djegia e mandateve, ambasadori britanik takon Bashën

Ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Tiranë, Duncan Norman, takoi pasditen e djeshme kreun e opozitës. Takimi vjen një ditë pas vendimit të opozitës për të djegur mandatet e deputetëve dhe dy ditë para protestës së paralajmëruar të së enjtes para parlamentit, ndërsa takimi është zhvilluar në selinë blu. Pas takimit, asnjë prej palëve nuk është prononcuar për mediat. Ditën e protestës, më 16 shkurt, ambasadori britanik u bëri thirrje opozitarëve për një protestë paqësore, duke iu bashkuar kështu zërave të ambasadorëve të tjerë europianë. Edhe gjatë ditës së hënë pati disa reagime nga zyrtarë të lartë të BE-së, që u sugjerojnë opozitës të mos djegë mandatet, por të vijojnë punën në parlament.



### Malltezi: Lefteri po detyrohet të hedhë "vallen" e Ramës

## Lefter Koka, kundër LSI: Nuk e djeg mandatin, na përdor Berisha

LSI iu bashkua unanimisht opozitës së bashkuar për të djegur mandatet, por dje deputeti i Durrësit, Lefter Koka, doli kundër vullnetit të grupit dhe kryetares Monika Kryemadhi. Ai deklaroi se është zgjedhur për të përfaqësuar popullin dhe shton se LSI po tërhiqet zvarrë nga Sali Berisha, njëri që sipas Kokës, bën thirrje për të qëlluar me "plumb ballit" në shekullin e 21. "Vendimi im i palëkundur është se unë nuk do të djeg mandatin e deputetit, që mijëra durrsakë më kanë besuar. I zgjedhur prej vullnetit të bashkëqytetarëve të mi, për të ushtruar pushtetin legjislativ dhe të jem përfaqësuesi i tyre. Parimet e mia në 2 dekada të jetës sime politike janë udhëhequr vetëm nga interesi i qytetarëve. Janë ata që më kanë treguar gjithmonë cila është e drejta dhe e vërteta, janë ata bashkudhëtarët dhe udhërrëfyesit e mi", tha z.Koka. Ky sipas tij, nuk është një vendim thjesht i Lëvizjes Socialiste për Integrim, por i Saliut, i cili në shekullin e 21 bën thirrje për plumba ballit. "Mandati im është besimi i mijëra qytetarëve. Është mandati i qytetarisë, kulturës dhe fisnikërisë durrsake, që as në ditët më të vështira të këtij qyteti nuk theu kurrë një xham. Qytetarët durrsakë kanë treguar në çdo kohë se ata janë shembulli më i mirë i shoqërisë shqiptare. Mandati im nuk mund të përdoret asesi për t'u vënë flakën institucioneve shtetërore apo parlamentit shqiptar. Thellësisht mirënjohës për të përfaqësuar sa më denjësisht zërin tuaj!", deklaroi z.Koka. Por, anëtari i kryesisë së PD-së, Jamarbër Malltezi, shprehet se Lefteri po detyrohet të hedhë "vallen e Ramës" për shkak të firmës që ka hedhur kur ishte ministër Mjedisi, në atë që e quan afera 178 milionë euro e inceneratorëve.

### BE, Soreca: Jo bojkot dhe djegie mandatesh, opozita të kthehet në Kuvend

# Djegia e mandateve, Ambasada e SHBA: Refuzoni thirrjet për dorëheqje

## "Kërcënimet minojnë parimet e demokracisë"

Valentina Madani

Ambasada e SHBA-ve reagoi dje fort ndaj vendimit të opozitës për djegien e mandateve në parlament. Sipas ambasadës amerikane, largimi nga Kuvendi minon parimet bazë të demokracisë. Vendimi i opozitës, siç thuhet në reagimin e ambasadës, minon parimet bazë të demokracisë. Po ashtu, theksohet se ky vendim saboton përparimin e rëndësishëm që Shqipëria ka arritur në zbatimin e ligjit dhe qeverisjen e përgjegjshme. Ambasada u bën thirrje deputetëve të heqin dorë nga ky vendim, pasi zhgënjehen njerëzit, të cilët i kanë zgjedhur për t'i përfaqësuar. Qëndrimi i ambasadës u paraqit nëpërmjet një statusi në "Facebook". "Një demokraci e shëndetshme kërkon një opozitë që funksionon në mënyrë konstruktive brenda institucioneve kushtetuese. Kërcënimet nga Partia Demokratike, Lëvizja Socialiste për Integrim dhe parti të tjera opozitare për të braktisur mandatet e tyre në parlament minojnë parimet bazë të demokracisë dhe sabotojnë përparimin e rëndësishëm, që Shqipëria ka arritur në zbatimin e ligjit dhe qeverisjen e përgjegjshme. Shtetet e Bashkuara u bëjnë thirrje të gjithë deputetëve të ngrihen mbi sherret politike, të refuzojnë thirrjet për të braktisur mandatet e tyre dhe të mbrojnë idealet dhe parimet që janë me rëndësi thelbësore për çdo demokraci të fortë. Nëse dështoni të bëni punën tuaj, do të zhgënjeni njerëzit, të cilëve keni privilegjin t'u shërbeni", thuhet në reagimin e ambasadës së SHBA-ve në Tiranë. Pas Brukselit, reagoi në Tiranë edhe ambasadori i Bashkimit Europian, Luigi Soreca, kundër bojkotit dhe lënies së mandateve nga opozita shqiptare. Soreca shprehet për "Top Channel" se kjo nuk çon në drejtimin e duhur dhe është kundër interesit të qytetarëve. Bashkimi Europian kërkon që mazhoranca dhe opozita të dialogojnë për të ulur tensionin. "Parlamenti është baza e çdo demokracie europiane. Ai është vendi ku duhet të diskutohen dhe të çohen përpara debatet mbi reformat dhe zhvillimet përkatëse. Parlamenti nuk duhet bojkotuar. Dëgjuam njoftimin nga partitë opozitare, që deputetët individualë do të heqin dorë nga mandatet e tyre aktuale. Çdo deputeti individual i takon të vendosë vetë se çfarë do të bëjë, me përgjegjësinë që kanë marrë para votuesve të tyre, për të mbrojtur pozitat dhe interesat e tyre në parlament. Kjo është detyra e tyre themelore. Është e qartë, megjithatë, se heqja dorë nga mandatet është dukshëm kundërproduktive për Shqipërinë dhe shkon kundër interesave të qytetarëve për reforma. 93% e shqiptarëve dëshirojnë t'i bashkohen BE-së, që do të thotë se janë votues nga të gjitha krahët e parlamenti", deklaroi ambasadori i BE-së në Tiranë.



Ambasada e SHBA-ve në Tiranë

**THIRRJA**

"Shtetet e Bashkuara u bëjnë thirrje të gjithë deputetëve të ngrihen mbi sherret politike, të refuzojnë thirrjet për të braktisur mandatet e tyre dhe të mbrojnë idealet dhe parimet që janë me rëndësi thelbësore për çdo demokraci të fortë. Nëse dështoni të bëni punën tuaj, do të zhgënjeni njerëzit, të cilëve keni privilegjin t'u shërbeni", thuhet në reagimin e ambasadës së SHBA-ve.

**LUIGI SORECA**

"Çdo deputeti individual i takon të vendosë vetë se çfarë do të bëjë me përgjegjësinë që kanë marrë para votuesve, për të mbrojtur pozitat dhe interesat e tyre në parlament. Kjo është detyra e tyre themelore. Megjithatë, është e qartë, se heqja dorë nga mandatet është dukshëm kundërproduktive për Shqipërinë dhe shkon kundër interesave të qytetarëve për reforma", tha z.Soreca.

**BUJAR NISHANI**

"Në Bruksel, ne shqiptarët kemi shumë miq dhe janë të respektueshëm. Por, askush prej tyre nuk e do Shqipërinë më shumë se shqiptarët. Unë nuk mund të bëhem hipokrit dhe të them se ata e duan Shqipërinë më shumë se ne, që kemi vendosur të jetojmë këtu. Edhe ambasadorët që janë akredituar këtu janë miq të mirë dhe partnerë të respektueshëm, por më shumë sesa shqiptarët nuk mund të jenë ambasadorët të interesuar për integrimin e Shqipërisë në BE", deklaroi z.Nishani.

### "Kryeministri gënjen kur kapet në flagrancë"

## PD: Rama, i lidhur me krimin, dosja "339" dhe VOA nuk janë të PD-së

PD-ja akuzoi dje kryeministrin Edi Rama se është i lidhur me krimin dhe se ai ka blerë zgjedhjet. PD reagoi dje ndaj deklaratës së kryeministrit Edi Rama në Pukë, lidhur me blerjen e votave. Deputeti demokrat, Gent Strazimiri, deklaroi se mohimi nga Rama për blerjen e zgjedhjeve është njësoj si mohimi për kriminalizimin e politikës dhe kanabizimin e vendit. Nënkryetari i grupit parlamentar të PD-së i kujtoi Ramës se dosja '339' dhe "Zëri i Amerikës" nuk janë të Partisë Demokratike. Strazimiri tha se Edi Ramës sot nuk i beson më askush, ndërsa u bëri thirrje qytetarëve të mar-



të e PD-së. Bandat që blejnë vota nuk janë të PD-së. Vangjush Dako, Arben Ndoka, Elvis Roshi, Damian Gjiknuri nuk janë të Partisë Demokratike, por janë njerëzit kyç që komunikojnë herë me bandat e krimit të organizuar, herë me banditët në krye të policisë për të blerë votat për llogari të Edi Ramës. Sa herë që Edi Rama do të tentojë të mashtrojë shqiptarët për pushtetin e blerë me krimin, PD do t'u tregojë shqiptarëve të vërtetën jo sipas nesh, por sipas 'Zërit të Amerikës'. As kjo media nuk është e PD-së. Ajo financohet nga Departamenti Amerikan i Shtetit, ka qenë për 46 vjet i vetmi zë i së vërtetës për shqiptarët dhe mbetet ende sot, zëri i së vërtetës së pamohueshme, të painfluencueshme, asaj që nuk është në shitje", tha z.Strazimiri.

MAZHORANCA
KRIZA

Kryeministri ka deklaruar se opozita do të dalë nga zgjedhjet vendore më e vogël

# Rama nuk tërhiqet: Do të zbatojmë kontratën me popullin deri në fund

## *Protestat, një film i parë sa herë afrohen zgjedhjen*

Kryeministri Edi Rama ka përjashtuar sërish në mënyrë kategorike mundësinë e dorëheqjes dhe krijimit të një qeverie transitore, siç edhe kërkon opozita. Nga Puka, ku vijoi turin e tij të takimeve "Bashkia që duam", kryeministri Rama nuk ka lënë pa komentuar edhe zhvillimet e fundit politike në vend dhe në mënyrë të veçantë nismën e opozitës për të djegur mandatet e deputetëve. Ai u shpreh i qartë, pavarësisht presionit në rritje të opozitës, se do ta çojë deri në fund kontratën e qeverisjes me qytetarët, madje duke bërë të ditur se do synojë të fitojë edhe zgjedhjet si ato vendore të 30 qershorit, ashtu edhe ato parlamentare të 2021. "Nuk kemi rrugë tjetër. Detyra jonë është të zbatojmë kontratën me popullin dhe të imponojmë atë që ka imponuar populli në zgjedhje. Kjo është e gjitha, të tjerat janë të thjeshta për t'u kuptuar. Për sa kohë do mendoni se shqiptarët do i bëni për budallenj, do ju lënë ku keni vendin, por edhe më pak do mbeteni. Në ballafaqimin e ardhshëm zgjedhor, populli do i lë aty ku janë po do jenë më pak seç janë sot", - u shpreh kryeministri Edi Rama. Duke u ndalur te protesta e opozitës, ai theksoi se kjo është një histori që përsëritet nga opozita sa herë që është para një palë zgjedhjesh. "Një rrugë që është e njohur për të gjithë, është një film i parë. Sa herë afrohen zgjedhjet, nisin avazin se nuk fitojnë dot. Ndërtuan një çadër, bllokuan rrugën dhe bënë çmos të shmangin zgjedhjet", - u shpreh Rama. Por, këtij here sipas tij, opozita ka edhe një arsye akoma më të madhe që proteston dhe kjo ka të bëjë me reformën në drejtësi dhe ngritjen e institucioneve të reja të drejtësisë. "Sot e njëjta situatë, ndërsa reforma në drejtësi po ecën dhe po hyn në fazën e ngritjes së institucioneve. Ata i vihen barrikadë vendit e drejtësisë e përdorin argumente vetëdiskritituese. Kujt shqiptari që di sadopak për procesin zgjedhor mund t'i besohet se këta që flasin për blerje votash janë zgjidhja e jo problemi, këta që flasin për korrupsion e varfëri janë zgjidhja e jo problemi. Kjo është arsye sa herë ka zgjedhje e nuk fitojnë dot, dalin nga binarët si mënyra për t'i ikur ballafaqimit me qytetarët e zgjedhësit", - deklaroi më tej Rama. Ai refuzoi edhe akuzat e opozitës për blerje votash nga socialistët, duke u kujtuar atyre se në zgjedhjet e shkuara vendore kishin ministrin e Brendshëm dhe të gjitha institucionet që merreshin me zgjedhjet. "Flasin për zgjedhjet e shkuara, po kush e ka harruar se në zgjedhjet e shkuara ata ishin në qeveri, kishin ministrin e Brendshëm, kishin institucionet. Si u blenë votat nga ne? Ua dhamë mundësinë, ua dhamë të gjitha, por me një kusht, të njohin rezultatin. Ngatërrojnë popullin në demokraci me punonjësit e bashkive apo ndjekësit fanatikë që i mbledhin për demonstrime force. Shumë keq për ta, aspak mirë për vendin", - nënvizoi kryeministri. Gjatë fjalës së tij, Rama tha se Puka sot ka pësuar një transformim të madh, ndërsa nuk ka lënë pa akuzuar edhe opozitën, për të cilën tha se edhe pse në opozitë, është pengesë për integrimin. "Sot jemi në një situatë krejt tjetër dhe rritet numri i atyre që vijnë për të kaluar një ditë apo edhe një natë. Sfida është të investohet më shumë. Fushë-Arrëzi ishte si të kaloje ferrin, por sot ka marrë një hije shprese, edhe pse problemet janë të mëdha. Dallimi mes nesh dhe atyre që sot edhe në opozitë kanë dalë hapur si pengesë për ecurinë e çeljes së negociatave dhe janë kthyer në bojatisë. Ata janë njësoj si dallimi mes Pukës sot dhe Pukës dje. Ata janë pa ide dhe pa vizion. Puka është një qytet i vogël dhe transformimi sot është spektakolar. Nëse do bënim një album fotografik, shumë do thoshin se është fotomontazh. Kur njerëzit na dhanë votën, ne nuk shkuam për pushime, por u kthyem për të dëgjuar njerëzit. Ne kemi një qeveri që më shumë se kurrë më parë shqiptarët i dëgjon dhe bën çmos për të zgjedhur problemet", - tha Rama.


Kryeministri Edi Rama, dje në Pukë

ZGJEDHJET
"Flasin për zgjedhjet e shkuara, po kush e ka harruar se në zgjedhjet e shkuara ata ishin në qeveri, kishin ministrin e Brendshëm, kishin institucionet? Si u blenë votat nga ne? Ua dhamë mundësinë, ua dhamë të gjitha, por me një kusht, të njihnin rezultatin. Ngatërrojnë popullin në demokraci me punonjësit e bashkive apo ndjekësit fanatikë që i mbledhin për demonstrime force".


Kryeministri Edi Rama, dje me banorët në Pukë

## Djegia e mandateve, Balla: Opozita ka hallin e reformës në drejtësi

Kryetari i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla, e lidh hapin e fundit të opozitës për të djegur mandatet me procesin e reformës në drejtësi dhe pikërisht me ngritjen e institucioneve të reja në drejtësi siç janë Byroja Kombëtare e Hetimit apo SPAK. Gjithsesi, ai ka theksuar se reforma në drejtësi jo vetëm që nuk ndalet nga djegia e mandateve, por se të enjten mazhoranca do të votojë strukturat e KLGJ dhe KLP. Sipas Ballës, vendimi i opozitës bie ndesh me atë që ndërkombëtarët presin nga faktori politik në vendin tonë, në kuadër të së ardhmes europiane. "Është e rëndësishme të bëhet e qartë për liderët e opozitës që nëse ata vazhdojnë të përbuzin parlamentin dhe mjetet demokratike, e vetmja gjë që do të arrijnë është distancimin e mëtejshëm të elektoratit prej tyre. Kjo sjellje është e papranueshme nga partnerët tanë ndërkombëtarë, të cilët nuk mbështesin as metodat e dhunshme dhe as këtë lloj retorike. Debati politik duhet të ndodhë brenda institucioneve shtetërore, pikë së pari brenda parlamentit. Asnjë parti politike në Shqipëri nuk ka të drejtë të dëmtojë perspektivën europiane të Shqipërisë. Mandatet e deputeteve përfaqësojnë vullnetin e popullit. Djegia e tyre do të thotë injorimi i këtij vullneti", - u shpreh Balla gjatë një takimi me strukturat e PS-së në Elbasan, në kuadër të zgjedhjeve të ardhshme lokale. Balla ka kërkuar nga socialistët që të përqendrohen te zgjedhjet vendore. Sipas Ballës, konkurrenti kryesor i socialistëve në zgjedhje nuk është opozita, por organizimi elektoral.





### I bllokuan rrugën Ramës, në polici nënkryetarja e Bashkisë Lezhë

Nënkryetarja e Bashkisë së Lezhës, Alfrida Marku dhe 10 qytetarë të tjerë të këtij qyteti janë proceduar dhe shoqëruar në polici për tubim të paligjshëm dhe bllokim të rrugës. Kjo, pasi gjatë paradites së djeshme, ata dhe dhjetëra banorë të Lezhës dhe Shkodrës bllokuan superstradën në hyrje të qytetit të Lezhës, aty ku do të kalonte kryeministri Edi Rama për të marrë pjesë në disa takime në Vaun e Dejës dhe Pukë, në kuadër të turit "Bashkia që duam". Qytetarët të mbështetur edhe nga përfaqësues të opozitës qëndruan në rrugë për rreth 1 orë, duke sjellë edhe përplasje me forcat e policisë. Përballë rezistencës së qytetarëve, eskorta e kryeministrit u detyrua të devijojë rrugën dhe të kalojë në një rrugë dytësore për të shkuar drejt Vaut Dejës.

### Bushati, në krah të Ramës: Duhen më shumë investime për veriun

Gati 1 muaj pasi u larguа nga detyra e ministrit të Jashtëm, Dimtir Bushati është shfaqur dje për herë të parë në krah të Ramës. Kjo ka ndodhur gjatë takimit të zhvilluar gjatë ditës së djeshme në Pukë, në kuadër të turit "Bashkia që duam". Në fjalën e tij në cilësinë e drejtuesit politikë për qarkun Shkodër, Bushati ka kërkuar më shumë investime dhe zhvillim për veriun e Shqipërisë. "Ky nuk është një debat thjeshtë estetik sesi të përmirësohet jeta në Pukë dhe në Fushë-Arrëz, por edhe sesi t'i jepet një zhvillim edhe më i madh zonës, duke pasur parasysh resurset që ka zona dhe mundësitë që përmes projekteve zhvillimore ne të kemi më shumë vizitorë, më shumë vende pune dhe t'u krijojmë mundësinë të rinjve që jetojnë në këtë zonë që jo vetëm të studiojnë dhe të shkollohen në Tiranë apo diku jashtë vendit, por të vijnë dhe të japin kontributin e tyre për zhvillimin e Pukës dhe Fushë-Arrëzit", - nënvizoi ai.



**KONFERENCA**
Në vijim të vizitës së tij zyrtare në Gjermani, Presidenti i Republikës, Ilir Meta mori pjesë edhe në Konferencën Vjetore të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme gjermane në Berlin, ku mbajti edhe një fjalë përshëndetëse si i ftuar nderi.



## Struktura, KLP do të ketë 65 punonjës dhe KLGJ do të ketë 125

Komisioni i Ligjeve miratoi dje me votat e mazhorancës strukturën e punonjësve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Në organin më të lartë qeverisës të akuzës numri i punonjësve do të jetë 65, megjithëse vetë KLP kishte kërkuar 75 vetë. Kreu i KLP-së, Gent Ibrahimi, tha se kjo shtesë duhet për shkak se me krijimin e SPAK dhe Byrosë së Hetimit rritet dhe volumi i punës. "Nevojat tona janë tani. Siç e dini ju Këshilli i Lartë i Prokurorisë është tani në procesin e kryerjes së dy detyrave më të rëndësishme, që i kryen tani në këto muaj përpara se të alokohet buxheti dhe strukturat. Jemi të detyruar nga ligji që ende pa u financuar dhe pa u mbështetur administrativisht dhe financiarisht të japim produkt sa i takon Prokurorisë së Posaçme, të japim produkt sa i takon Prokurorit të Përgjithshëm", theksoi z.Ibrahimi. Po ashtu edhe për Këshillin e Lartë Gjyqësor numri i personelit shkoi në 125 nga 144 që kishin kërkuar vetë krerët e këtij institucioni. Në fund të seancës, kreu i Komisionit të Ligjeve, Ulsi Manja, u shpreh se reforma në drejtësi do të vazhdojë dhe se askush nuk e pengon, pavarësisht djegies së mandateve të opozitës. "Me mandate të djegura apo me mandate të plota, një gjë është e qartë: Kuvendit të Shqipërisë i takon vetëm të japë suportin e duhur financiar për funksionimin e këtyre organeve, por nuk ka asgjë që e pengon reformën në drejtësi dhe ngritjen e institucioneve të reja të drejtësisë",- deklaroi z.Manja.

Kreu i shtetit, Ilir Meta u prit nga homologu i tij gjerman, Frank-Walter Steinmeier

# Meta takon Steinmeier: Marrëveshja e Prespës, shembull për Kosovë-Serbi

## *Gjermania, mbështetëse kryesore e integrimit për Shqipërinë*

Presidenti Ilir Meta u prit dje një takim të veçantë nga Presidenti i Gjermanisë, Frank-Walter Steinmeier. Gjatë takimit presidenti Meta vlerësoi marrëdhëniet e shkëlqyera midis dy vendeve dhe shprehu mirënjohjen e thellë për mbështetjen 30-vjeçare të Gjermanisë për zhvillimin e Shqipërisë. Në mënyrë të veçantë, Presidenti Meta vlerësoi vëmendjen e madhe që Presidenti Steinmeier dhe Gjermania u kushtojnë marrëdhënieve me Shqipërinë dhe zhvillimeve në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Duke u ndalur te zhvillimet më të fundit në rajon, të dy presidentët ndanë të njëjtin vlerësim se arritja e Marrëveshjes së Prespës është një shembull i suksesshëm që inkurajon edhe Kosovën edhe Serbinë për normalizimin e marrëdhënieve dhe arritjen e një marrëveshjeje të qëndrueshme në interesin më të mirë të paqes, stabilitetit dhe integrimit europian.



Presidenti Ilir Meta dje me Presidentin e Gjermanisë, Frank-Walter Steinmeier

Nga ana e tij, Presidenti Steinmeier e siguroi Presidentin Meta se Gjermania do të vazhdojë të jetë një partner i rëndësishëm dhe mbështetës kryesore në proceset integruese për Shqipërinë dhe të gjitha vendet e rajonit, me synim jo vetëm ruajtjen e stabilitetit dhe paqes në Ballkan, por mbi të gjitha, për t'i ndihmuar ata në avancimin e reformave për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, forcimin e shtetit ligjor dhe prosperitetin e popujve të rajonit. Në fund të takimit, Presidenti Meta e ftoi Presidentin Steinmeier për një vizitë zyrtare në Shqipëri, që u mirëprit me kënaqësi.

**KONFERENCA**

Në vijim të vizitës së tij zyrtare në Gjermani, Presidenti i Republikës, Ilir Meta mori pjesë edhe në Konferencën Vjetore të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme gjermane në Berlin, ku mbajti edhe një fjalë përshëndetëse si i Ftuar Nderi. Konferenca vjetore është një nga aktivitetet më të rëndësishme politike dhe ekonomike në Berlin, ku marrin pjesë mbi 3500 personalitete të shquara gjermane dhe ndërkombëtare të politikës, botës së biznesit dhe shoqërisë civile. Presidenti Meta gjatë fjalës së Tij, vlerësoi partneritetin strategjik dhe marrëdhëniet e shkëlqyera të bashkëpunimit në të gjitha fushat mes Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë. Presidenti Meta gjatë fjalës së tij bëri një ekspoze të potencialeve në sektorët prioritar, ku renditi mes të tjerash dhe disa oportunitete investimesh për biznesin e huaj dhe atë gjerman në veçanti.

**FTESA**

Në mënyrë të veçantë Presidenti Meta ftoi biznesin gjerman për mundësitë e investimeve në sektorin e turizmit dhe energjetikës në Shqipëri. "Ftesa ime e sinqertë dhe e drejtpërdrejtë është që t'ju ftoj në Shqipëri jo vetëm si turistë për të shijuar bukuritë e saj të jashtëzakonshme, por edhe si investitorë potencial duke shfrytëzuar kapitalin tuaj financiar dhe ekspertizën menaxheriale në sektorin e turizmit"-theksoi Presidenti Meta. Kreu i Shtetit prej disa vitesh ndodhet në një vizitë zyrtare në Gjermani ku morri pjesë në edicion të 55-të të Konferencës së Sigurisë së Mynihut, ku u diskutuan dhe debatuan një sërë çështjesh lidhur me zhvillimet aktuale botërore, sfidat e rendit liberal botëror, multilateralizmi, marrëdhëniet transatlantike e kërcënime e reja për paqen dhe sigurinë në botë. Gjatë pjesëmarrjes në Konferencë, Presidenti Meta u takua edhe me një sërë homologësh e personalitete pjesëmarrëse, përfshi edhe kancelaren gjermane, Angela Merkel dhe Presidentin e Armenisë, Armen Sarkissian.

### Akuzat, Spiropali paralajmëron padi në gjykatë

## PD: Familja e Spiropalit përfitoi 550 mln lekë fonde publike

PD-ja publikoi një skemë ku pretendohet se në mënyrë korruptive dhe konflikt interesi, familja e ministres Elisa Spiropali, ka marrë nga fondet publike 550 milionë lekë. Drejtuesja e Departamentit Antikorrupsion, në PD Lealba Pelinku, tha se në skemën korruptive është përfshirë direkt vëllai, bashkëshorti dhe vetë Elisa Spiropali. "550 milionë lekët janë marrë me tenderë të vegjël, që nuk tërheqin vëmendjen. Me tenderë 6-7 milionësh, bashkëshorti i Elisa Spiropali i ka dhënë kompanisë së krijuar nga kunati i tij, vëllai i Elisës rreth 350 milionë lekë. Është e faktuar si nga transaksionet e thesarit, ashtu edhe nga të dhënat e Tenderëve Publikë se ish-drejtoresha e doganave ka blerë përmes tenderëve deri edhe traun e doganës në kompaninë e vëllait të saj. Sipas të dhënave të siguruara nga Thesari i Shtetit, kompania Solomon, në kundërshtim me ligjet e vendit, ka përfituar fonde dhe tenderë edhe nga drejtoria e Doganave Fier, në të njëjtën kohë kur Elisa Spiropali ishte drejtoreshë doganash. Më pas, edhe dogana Vlorë është në listën e atyre që kanë dhënë miliona. Më saktë rreth 67 milionë lekë", deklaroi zj. Lealba Pelinku. Akuzat e PD, zëdhënësja e qeverisë, Elisa Spiropali do t'i çojë në gjykatë. Spiropali hedh poshtë të gjitha pretendimet dhe akuzat e PD për afera korruptive dhe përfitim të tenderëve nga kompania e vëllait të saj. "Vëllai im nuk ka përfituar kurrë dhe asnjëherë asnjë kontratë apo fond publik, as kur isha beqare, as kur u martova, as kur isha aktiviste, as kur isha drejtore, e as tani si ministre. Po fjalët me këta gojështhurur janë të tepërta. Padia është e vetmja rrugë me këta bartës e përçues të horrllëkut politik. Në gjykatë le të provojnë çfarë akuzojnë ose përndryshe paratë për dëmin do të shkojnë për të ndihmuar kopshtin e Kolonjës",-theksoi zj.Spiropali.



**JORIDA TABAKU**
Deputetja Tabaku i kërkoi Inspektoratit të Pasurive të nisë menjëherë hetim pasuror për atë që e quan pasuri të paligjshme të Spiropalit.

Zbulohet projektligji që shkrin inspektoratet ekzistuese. Krijohen 6 megainspektorate

# Shkrihen 30 inspektorate, qindra persona rrezikojnë vendet e punës

## *Nisma synon të shmangë mbivendosjet e kompetencave*

Fill pas zgjedhjeve parlamentare të 2017, socialistët me marrjen e mandatit të dytë të qeverisjes prezantuan edhe një platformë të re qeverisëse, që kishte në thelb një qeveri të vogël dhe riorganizim të një sërë institucionesh. Kështu, veç shkrirjes dhe bashkimit të disa ministrive, mazhoranca u zotua që të shkrijë apo bashkojë dhe një sërë institucionesh të tjera të nivelit të dytë. Angazhim që duket se ka nisur tashmë të vihet në jetë. Të majtët kanë vendosur dhe brenda pak ditësh pritet të shkrihet hipoteka dhe ALUIZNI për të krijuar Kadastrën. Por kjo është vetëm një pjesë e punës, pasi qeveria ka vendosur të ndërmarrë një hap tjetër për të shkrirë thuajse të gjitha inspektoratet dhe drejtoritë e hetimit dhe kontrollit që funksionojnë aktualisht. Qeveria ka përgatitur një projektligj, të cilin e ka hedhur për diskutim te institucionet që preken dhe që parashikon rreth 30 trupat inspektuese që funksionojnë aktualisht të bashkohen dhe të funksionojnë në vetëm 6 të tilla.

**PROJEKTLIGJI**

Objektivi i këtij projektligji që është propozuar është riorganizimi i trupave inspektuese shtetërore sipas fushave të inspektimit me funksione të ngjashme inspektuese, për të shmangur mbivendosjet e kompetencave ligjore, si dhe për një menaxhim dhe koordinim më të mirë të ISH-ve. Nisur nga kjo, projektligji sugjeron riorganizimin e të gjitha trupave inspektuese me funksione të përbashkëta ose të ngjashme inspektuese, duke bërë të mundur që 30 trupat inspektuese t'i organizojë në vetëm 6 të tilla. Natyrisht, që ky riorganizim do të sjellë dhe një reduktim të numri të vendeve të punës dhe shumë persona pritet të humbasin punën.

**RIORGANIZIMI**

Projektligji parashikon krijimin e Inspektoratit Shtetëror të Shëndetësisë dhe Ushqimit, duke krijuar një megainspektorat, i cili duhet të jetë përgjegjës për kontrollin e sigurimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe zinxhirit ushqimor, duke siguruar mbrojtjen e interesit publik. Për krijimin e tij shkrihen Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, Drejtoria e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës, Drejtoria e Shërbimit Veterinar, Zyra për Mbrojtjen nga Rrezatimet, Fondi i sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Tokës. Një tjetër trup inspektuese që krijohet është Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Territorit dhe pjesë e tij do të jenë: Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Agjencia Kombëtar e Zonave të Mbrojtura dhe Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore. Trupa e tretë inspektuese që krijohet është Inspektorati Shtetëror i Teknikës dhe Teknologjisë. Pjesë e këtij inspektorati do jenë inspektoratet ekzistuese si: Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencën në Miniera, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore. Institucioni i katërt inspektues që krijohet është Inspektorati Shtetëror i Transportit dhe Infrastrukturës, si inspektorat që mbikëqyrës dhe kontrollin sektorin e infrastrukturës dhe transportit rrugor, detar, hekurudhor dhe të aviacionit. Për krijimin e tij shkrihen: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Përgjithshme Detare, Drejtoria e Inspektimit të Hekurudhave dhe Inspektorati Teknik i Digave dhe Dambave. Krijohet po ashtu Inspektorati Shtetëror i Ekonomisë dhe për krijimin e tij do të shkrihen: Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, Drejtoria e Hetimit Tatimor dhe Drejtoria e Hetimit Doganor. Institucioni gjashtë inspektues që krijohet është Inspektorati Shtetëror i Çështjeve Sociale dhe ai do ketë funksionet që sot i kryejnë Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Instituti i Sigurimeve Shëndetësore, Inspektorati Shtetëror i Arsimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.


Kryemisnistri Edi Rama gjatë një mbledhjeje me ministrat

**SHKURTIMET**

Nisur nga kjo, projektligji sugjeron riorganizimin e të gjitha trupave inspektuese me funksione të përbashkëta ose të ngjashme inspektuese, duke bërë të mundur që 30 trupat inspektuese t'i organizojë në vetëm 6 të tilla. Natyrisht që ky riorganizim do të sjellë dhe një reduktim të numri të vendeve të punës dhe shumë persona pritet të humbasin punën.

### PROJEKTLIGJI

■ **NENI 10**

**2.** "Këshilli i Ministrave me propozim të Inspektoratit të Përgjithshëm Shtetëror miraton rregullat e organizimit e të funksionimit të inspektorateve shtetërore, funksionet e inspektimit në kompetencë të tyre, si dhe numrin dhe juridiksionin territorial të drejtorive të tyre, nëse ka të tilla".

**3.** "Struktura dhe organika e inspektorateve shtetërore miratohet nga Kryeministri, me propozim të Inspektoratit të Përgjithshëm Shtetëror".

■ **NENI 11**

Pika 1 dhe 2 ndryshohen si më poshtë:

**1.** "Çdo inspektorat shtetëror drejtohet nga Kryeinspektori Shtetëror".

**2.** "Kryeinspektori Shtetëror emërohet dhe lirohet nga detyra nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit përgjegjës dhe Inspektorit të Përgjithshëm Shtetëror".

Në pikën 3, fjala "kryeinspektori" zëvendësohet me "Kryeinspektori Shtetëror" dhe fjalët "miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave" zëvendësohen me fjalët, "miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të Ministrit përgjegjës dhe Inspektorit të Përgjithshëm Shtetëror".

■ **NENI 12**

Pas nenit 12 shtohet neni 12/1 me këtë përmbajtje:

■ **"NENI 12/1**

Emërimi dhe lirimi nga detyra i nivelit të mesëm, të ulët dhe ekzekutiv në Inspektoratet Shtetërore.

"Emërimi dhe lirimi nga detyra i nivelit të mesëm, të ulët si dhe atij ekzekutiv në inspektoratet Shtetërore bëhet nëpërmjet Departamentit të Administratës Publike bazuar në legjislacionin për nëpunësin civil, dhe akteve nënligjore që përcaktojnë kushtet dhe kriteret profesionale të rekrutimit dhe të karrierës".

■ **NENI 32 :**

Pika 1 ndryshon si më poshtë:

1. **Inspektimi i njoftohet nëpërmjet njoftimit** paraprak të autorizimit për kryerjen e inspektimit, subjektit të inspektimit, jo më vonë se 7 ditë përpara fillimit të veprimeve të inspektimit, nga trupa inspektuese".

■ **NENI 33**

Vendi i inspektimit "Vendi i inspektimit përcaktohet në autorizim. Vendi i inspektimit është kudo ku kryen veprimtarinë e tij subjekti i inspektimit dhe ndodhen faktet që lidhen me respektimin apo mosrespektimin e kërkesave ligjore".

### NISMA, JA INSPEKTORATET QË KRIJOHEN DHE ATA QË SHKRIHEN

■ **Krijohet:**
Inspektoratin Shtetëror të Shëndetësisë dhe Ushqimit

■ **Shkrihen**:
Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
Inspektorati Shtetëror Shëndetësor
Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore
Drejtoria e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës
Drejtoria e Shërbimit Veterinar
Zyra për Mbrojtjen nga Rrezatimet
Fondi i sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor
Inspektorati i Mbrojtjes së Tokës

■ **Krijohet:**
Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Territorit

■ **Shkrihen:**
Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit
Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit
Agjencia Kombëtar e Zonave të Mbrojtura
Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore.

■ **Krijohet:**
Inspektorati Shtetëror i Teknikës dhe Teknologjisë

■ **Shkrihen:**
Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial
Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencën në Miniera
Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (MM)
Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore

■ **Krijohet:**
Inspektorati Shtetëror i Transportit dhe Infrastrukturës

■ **Shkrihen:**
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
Autoriteti i Aviacionit Civil
Drejtoria e Përgjithshme Detare
Drejtoria e Inspektimit të Hekurudhave
Inspektorati Teknik i Digave dhe Dambave

■ **Krijohet:**
Inspektorati Shtetëror i Ekonomisë

■ **Shkrihen:**
Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut
Drejtoria e Hetimit Tatimor
Drejtoria e Hetimit Doganor

■ **Krijohet:**
Inspektorati Shtetëror i Çështjeve Sociale

■ **Shkrihen:**
Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore
Instituti i Sigurimeve Shoqërore
Instituti i Sigurimeve Shëndetësore
Inspektorati Shtetëror i Arsimit
Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave

**Shoqeria permbarimore JUSTITIA**

Shoqeria permbarimore JUSTITIA shpall ankandin, faza e PARE , për shitjen e pasurisë së paluajtshme per te cilen ka vene hipoteke BKT BANK, me këto të dhëna:
Pasuria "ARE" nr. 17/5, Zona Kadastrale 3339, me sipërfaqe 7780 m² faqe 190 vol.5, e ndodhur në Vrrin Duurrës, në pronësi të z.Adrian Sefer Kapllani dtl.08.03.1969, zj.Merita Myzafer Kapllani dtl.24.06.1970
Në vlerën 11.600.000 (njëmbëdhjetë milion e gjashtëqind mijë ) Lekë.
Pasuria Apartament me sip.120m2 nr.pas.41/150+1-1 zk.8518 vol.116 fq.54 me adresë:Plazh /13 Durrës në pronësi të z.Adrian Sefer Kapllani dtl.08.03.1969.
Në vlerën 5.381.856 (pese milion e treqind e tetëdhjetë e një mijë e teteqind e pesëdhjetë e gjashtë ) Lekë.

Ankandi zhvillohet në datën 07.03.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbaruesit gjyqësor me adrese Bulevardi"Bajram Curri", Pall. 21,Shk. 3, Ap. 18, Tiranë.

**SHPALLJE ANKANDI**

**Zyra Permbarimore "E.G Bailiff Service"** me përmbarues gjyqësor Enuar Merko me adrese Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tirane, njofton se më datë 15.03.2019 ora 8 ºº - 16 ºº ne ambjentet e saj, do te zhvillohet: Ankandi i II-të për shitjen e 4 pasurive të paluajtshme , në pronësi të Shoqërisë "VICTORY INVEST" SH.P.K me vlera fillestare ne ankand: a)176,867.6 (Njëqind e shtatëdhjet e gjashtë mijë e tetëqind e gjashtëdhjet e shtatë pikë gjashtë) USD për Pasurinë e paluajtshme, Ullishte me sipërfaqe totale 2,795 m², rregjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 547/66, Vol.18, Fq.152, ZK.2704 e ndodhur në Mjull-Bathore në pronësi të Shoqërisë "VICTORY INVEST" SH.P.K. ;b)171,172.4 (Njëqind e shtatëdhjet e një mijë e njëqind e shtatëdhjet e dy pikë katër) USD për Pasurinë e paluajtshme, Ullishte me sipërfaqe totale 2,705 m², rregjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 547/67, Vol.18, Fq.153, ZK.2704 e ndodhur në Mjull-Bathore në pronësi të Shoqërisë "VICTORY INVEST" SH.P.K.; c) 221,480 (Dyqind e njëzet e një mijë e katërqind e tetëdhjet) USD për Pasurinë e paluajtshme, Ullishte me sipërfaqe totale 3,500 m², rregjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 547/72, Vol.19, Fq.146, ZK.2704 e ndodhur në Mjull-Bathore në pronësi të Shoqërisë "VICTORY INVEST" SH.P.K.; d)94,920 (Nëntëdhjet e katër mijë e nëntëqind e njëzet) USD për Pasurinë e paluajtshme, Ullishte me sipërfaqe totale 1,500 m², rregjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 547/73, Vol.19, Fq.147, ZK.2704 e ndodhur në Mjull-Bathore në pronësi të Shoqërisë "VICTORY INVEST" SH.P.K. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

Në kërkim shoku i viktimës. Ngjarja dyshohet të ketë lidhje me prishjen e pazareve të drogës

# U denoncua i zhdukur 2 javë më parë, gjendet i vrarë brenda në makinë 32-vjeçari nga Tepelena

## *Trupi i pajetë i babait të 2 fëmijëve u gjet nga kalimtarët në një greminë në Limar të Këlcyrës*

PËRMET

Një 32-vjeçar i denoncuar i zhdukur që prej 6 shkurtit të këtij viti është gjetur i vrarë brenda në makinën e tij, në vendin e quajtur "Përroi i Thellë" në Këlcyrë. Kanë qenë banorët e zonës, të cilët kanë lajmëruar policinë kur kanë pikasur makinën në greminë. Viktima është Sokol Rama nga fshati Mamaj i Tepelenës. Menjëherë pas sinjalizimit për gjetjen e trupit të pajetë, uniformat blu kanë shkuar në vendngjarje dhe kanë nisur hetimet. Paraprakisht, policia dyshon se vrasja e të riut ka lidhje me prishjen e pazareve të drogës dhe se autor i krimit është shoku i tij, Roland Milo, i cili është shpallur në kërkim. Milo, nga fshati Miçan i Frashërit në Përmet rezulton se është shoferi administratorit të Njësisë Administrative Frashër. Policia e Tepelenës e ka bërë më herët identifikimin e vrasësit të dyshuar, por pritej të gjendej trupi dhe të krijonin bindjen e arsyeshme që është ai i dyshuari. Policia bën me dije se nga këqyrja paraprake nga grupi hetimor dyshohet se i riu është vrarë me armë zjarri. Po sipas policisë, dyshohet se Milo kishte implikuar Ramën në trafikun e lëndëve narkotike. Prej afro dy javësh 32-vjeçari Sokol Rama dhe shoku i tij, Roland Milo janë deklaruar të zhdukur nga familjarët. Fillimisht është deklaruar i zhdukur nga të afërmit e tij Rama. Ai është një emër i njohur për policinë lokale, pasi rezulton person me precedentë penalë, i akuzuar për vjedhje, ndërsa dyshimet janë se zhdukja e tij dhe shokut ka lidhje me transportin e lëndëve narkotike, pasi Sokol Rama është identifikuar nga policia lokale si transportues droge. Familjarët e Sokol Ramës dhe shokut të tij kishin denoncuar zhdukjen e tij në Komisariatin e Policisë Tepelenë.



32-vjeçari i vrarë, Sokol Rama



Roland Milo, i shpallur në kërkim nga policia

### KUSH KLUSH ËSHTË VIKTIMA

Sokol Rama, babai i dy fëmijëve të mitur, është një emër i njohur për policinë lokale. Ai ishte person me precedentë penalë, i akuzuar për vjedhje, ndërsa dyshimet janë se zhdukja e tij dhe shokut të tij, Roland Milo nga Përmeti, i deklaruar i zhdukur dy ditë pas denoncimit të familjarëve të Ramës, ka lidhje me transportin e lëndëve narkotike, pasi Rama është identifikuar nga blutë si transportues droge. Pasi kërkuan prej një jave nga dita e alarmit të familjarëve, policia vuri në dispozicion edhe një helikopter për krehjen e zonës nga ajri. Ndërkohë që nga përgjimi i telefonave të Sokol Ramës, policia arriti të bënte më herët identifikimin e sinjalit telefonik të njërit prej telefonave në përdorim të tij, në Frashër të Përmetit. Të dy shtetasit, miq me njëri-tjetrin dhe bashkëpunëtorë janë në listën e personave me precedentë kriminalë. Sokol Rama është dënuar më parë për vjedhje, ndërsa Milo, rreth 40 vjeç, punon aktualisht si shofer i administratorit të Njësisë Administrative Frashër, por njihet nga policia si person që merrej me trafikimin e lëndës narkotike, edhe pse ende i paskeduar si i tillë. Që në fillim burimet thanë se ka dyshime se zhdukja e tyre mund të ketë ardhur si pasojë e prishjes së pazareve të drogës.

**I KËRKUARI**

Dy ditë pas denoncimit të familjarëve të Sokol Ramës, është denoncuar i zhdukur edhe shoku i tij nga fshati Miçan i Frashërit në Përmet, Roland Milo. Ndërkaq, burime nga policia dje bënë me dije se Milo është shpallur në kërkim, pasi dyshohet të jetë autor i vrasjes së 32-vjeçarit Sokol Rama. Sipas bluve, Milo kishte implikuar viktimën në trafikun e lëndëve narkotike.


REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

NJOFTIM PËR PUNËSIM

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, njofton fillimin e procedurave për rekrutimin në rang vendi të trajnuesve për trajnimin e administratës zgjedhore që do të ngrihet për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019:

54 trajnues për trajnimin e anëtarëve të Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor (KZAZ-ve);
280 trajnues për trajnimin e anëtarëve të Komisioneve të Qendrave të Votimit (KQV-ve);
94 trajnues për trajnimin e anëtarëve të Grupeve të Numërimit të Votave (GNV-ve).

Në faqen e internetit të KQZ www.cec.org.al, në rubrikën "njoftime" gjeni të publikuar numrin e kërkuar të trajnuesve për çdo qark/bashki dhe për çdo nivel të administratës zgjedhore.

KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJNË APLIKANTËT:

1. Të jetë me arsim të lartë, diplomë "Master i shkencave" ose "Master i arteve të bukura" apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
2. Të ketë përvojë pune (të paktën 3-5 vite) në fushën e së drejtës, administratën publike, mësimdhënie, në OJF që kanë objekt të veprimtarisë së tyre rritjen e kapaciteteve permes zhvillimit te trajnimeve, në procese zgjedhore, si dhe çdo përvojë pune e barasvlefshme me to;
3. Të jetë me vendbanim brenda qarkut, ku ata do të angazhohen si trajnerë të komisionerëve zgjedhorë ( KZAZ-ve, KQV-ve, GNV-ve);
4. Të mos jetë i zgjedhur në organet drejtuese qendrore dhe vendore të partive politike;
5. Të mos jetë kandidat për organet e qeverisjes vendore (kryetar/këshilltar bashkie);
6. Të mos jetë në detyrë në strukturat e organeve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, inspektoriati qendror apo lokal, policie private, ushtarak aktiv i Forcave të Armatosura, punonjës i Shërbimit Informativ;
7. Të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
8. Të mos jetë i dënuar administrativisht për shkelje të dispozitave, të cilat lidhen me zgjedhjet apo të jenë larguar nga shërbimi civil;
9. Të ketë aftësi komunikimi, menaxhimi dhe raportimi, të përdorë lehtësisht programet bazë kompjuterike.

APLIKIMI:

Brenda datës 28 shkurt 2019, kandidatët duhet të paraqesin në KQZ (Zyra e Protokollit), adresa Rruga "Ibrahim Rugova" nr. 4, dokumentacionin:
1. Këkesë për aplikim, ku të përcaktohet interesi për angazhim (trajnues i KZAZ, KQV, GNV) si dhe numër telefonik kontakti;
2. Jetëshkrimi (CV);
3. Diplomë e shkollës së lartë (e noterizuar);
4. Kopje e librezës së punës (e noterizuar);
5. Kopje të dokumentit të identifikimit, letërnjoftimi/kartë identiteti ose pasaportë;
6. Çertifikatë personale ose vërtetim nga njësia administrative për vendbanimin;
7. Çertifikatë ose dokument tjetër, që vërteton eksperiencën zgjedhore apo si trajnues (nëse ka);
8. Deklaratë, e firmosur, për përmbushjen e kritereve të përzgjedhjes, pikat 4, 5, 6, 7 dhe 8.

Përzgjedhja e kandidaturave do të bëhet sipas procedurave të përcaktuara në vendimin e KQZ nr. 17, datë 1.02.2019 "Strategjia e Trajnimit të komisionerëve zgjedhorë, për zgjedhjet për organet e pushtetit vendor 2019":
- Përmbushja e kritereve (vlerësimi i dokumentacionit);
- Intervista me gojë për njohuritë për Kodin Zgjedhor, aftësitë teknike, profesionale, metodologjike, komunikimit, menaxhimit të punës në grup. Vendi, data, dhe ora e intervistave do të njoftohen në faqen zyrtare të KQZ-së.

Masa e pagesës së trajnuesit do të jetë sipas përcaktimeve të VKM nr. 138, datë 02.03.2014 "Për rregullat e organizimit e të funksionimit të shkollës shqiptare të administratës publike dhe trajnimin e nëpunësve civil", i ndryshuar.



Shoqeria permbarimore JUSTITIA:

Shpall ankandin, faza I, për shitjen e pasurisë së paluajtshme per te cilat ka vene hipoteke NBG BANK/ABI BANK, me këto të dhëna:

1. Pasuria me numër 5/1-B2, sip 115 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.2, K. Nëntokë, B2, Shengjin, Lezhe, e rregjistruar ne rregjistrin hipotekor Nr. 454, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 25.600 (njëzet e pesëmijë e gjashtëqind ) Euro.

2. Pasuria me numër 5/1+1-28, sip 59.1 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.2, SH. 1 K. 4, AP. 28, Shengjin, Lezhe, e rregjistruar ne rregjistrin hipotekor Nr. 448, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 18,000(tetëmbëdhjetë mijë ) Euro.

3. Pasuria me numër 5/1+1-47, sip 53.2 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.3, SH. 1 K. 7, AP. 47, Shengjin, Lezhe, e rregjistruar ne rregjistrin hipotekor Nr. 458, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 16,160 (gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë ) Euro.

4. Pasuria me numër 5/1-B1, sip 119.62m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.2, K. Nëntokë, B1, Shengjin, Lezhe, e rregjistruar ne rregjistrin hipotekor Nr. 453, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 26.400 (njëzet e gjashtë mijë e katër qind) Euro.

5. Pasuria me numër 5/1+1-45, sip 27.01 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.3, SH. 1 K. 7, AP. 45, Shengjin, Lezhe, e rregjistruar ne rregjistrin hipotekor Nr. 456, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 8,240(tetë mijë e dyqind e dyzet) Euro.

6. Pasuria me numër 5/1+1-46, sip 26.45 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.3, SH. 1 K. 7, AP. 46, Shengjin, Lezhe, e rregjistruar ne rregjistrin hipotekor Nr. 457, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 8,080(tetë mijë e tetëdhjetë ) Euro.

7. Pasuria me numër 5/1+1-49, sip 59.1 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.3, SH. 1 K. 4, AP. 49, Shengjin, Lezhe, e rregjistruar ne rregjistrin hipotekor Nr. 460, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 17.520 (shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind e njëzet ) Euro.

8. Pasuria me numër 5/1+1-44, sip 59.1 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.3, SH. 1 K. 7, AP. 44, Shengjin, Lezhe, e rregjistruar ne rregjistrin hipotekor Nr. 447, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 18,000(tetëmbëdhjetë mijë ) Euro.

9. Pasuria me numër 5/1+1-43, sip 67.73 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.3, SH. 1 K. 7, AP. 43, Shengjin, Lezhe, e rregjistruar ne rregjistrin hipotekor Nr. 446, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 20,080 (njëzet mijë e tetëdhjetë) Euro.

10. Pasuria me numër 5/1+1-25, sip 26.45 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.2, SH. 1 K. 4, AP. 25, Shengjin, Lezhe, e rregjistruar ne rregjistrin hipotekor Nr. 445, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 8,080(tetë mijë e tetëdhjetë ) Euro.

11. Pasuria me numër 5/1+1-26, sip 53.2 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.2, SH. 1 K. 4, AP. 26, Shengjin, Lezhe, e rregjistruar ne rregjistrin hipotekor Nr. 450, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 16,160 (gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë ) Euro.

12. Pasuria me numër 5/1+1-48, sip 70.38 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.3, SH. 1 K. 7, AP. 48, Shengjin, Lezhe, e rregjistruar ne rregjistrin hipotekor Nr. 459, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 20,080 (njëzet mijë e tetëdhjetë) Euro.

13. Pasuria me numër 5/1+1-24, sip 27.01 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.2, SH. 1 K. 4, AP. 24, Shengjin, Lezhe, e rregjistruar ne rregjistrin hipotekor Nr. 451, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 8,240(tetë mijë e dyqind e dyzet) Euro.

14. Pasuria me numër 5/1+1-23, sip 59.1 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.2, SH. 1 K. 4, AP. 23, Shengjin, Lezhe, e rregjistruar ne rregjistrin hipotekor Nr. 452, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 18,000(tetëmbëdhjetë mijë ) Euro.

15. Pasuria me numër 5/1+1-22, sip 67.73 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.2, SH. 1 K. 4, AP. 22, Shengjin, Lezhe, e rregjistruar ne rregjistrin hipotekor Nr. 455, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 21,680 (njëzet e njëmijë e gjashtëqind e tetëdhjetë ) Euro.

16. Pasuria me numër 5/1+1-27, sip 70.38 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.2, SH. 1 K. 4, AP. 27, Shengjin, Lezhe, e rregjistruar ne rregjistrin hipotekor Nr. 449, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 20,080 (njëzet mijë e tetëdhjetë) Euro.

**Ankandi zhvillohet në datën 22.02.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbaruesit gjyqësor .Adresa: Bulevardi"Bajram Curri", Pall. 21,Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studio-justitia.com, tel. +355 4 2270890**

## Ngjarja në prill të 2016-ës, ja si u vra nëna e 3 fëmijëve

# Mbyti gruan e pronarit me porosi të tij, prokuroria kërkon burgim të përjetshëm për Fatjon Karmeshtnën



Biznesmeni Sadetin Sula me bashkëshorten



I akuzuari, Fatjon Karmeshtna

**SHKODËR** - Prokuroria për Krime të Rënda ka kërkuar dënimin me burgim të përjetshëm për Fatjon Karmeshtnën, i akuzuar si vrasësi i Suela Sulës, me porosi të bashkëshortit të saj Sadetin Sula. Sipas organit të akuzës, 36-vjeçari është personi që ka mbytur me duar nënën e tre fëmijëve në tualetin e mobilierisë së familjes Sula në Shkodër në prill të vitit 2016. Për këtë ngjarje është dënuar me burgim të përjetshëm nga Gjykata e Shkallës së Parë dhe burri i viktimës, Sadetin Sula. Në seancën e djeshme, prokuroria lexoi dëshmitë, provat materiale dhe shkencore, që sipas të cilave ekzekutori është Fajton Karmeshtna dhe qëllimi i krimit është përfitimi material, pasi ka marrë shuma monetare të caktuara nga bashkëshorti i viktimës. Suela Sula u gjet e pajetë më 18 prill të vitit 2016, në orën 12:30, në fshatin Melgushë të Shkodrës. Trupi i nënës së tre fëmijëve u gjet në tualetin e mobilierisë, në të cilën viktima ishte bashkëpronare. Ajo ishte shoqëruar në punë nga bashkëshorti i saj, Sadetin Sula, i cili më pas është kthyer në qytetin e Shkodrës. Si fillim rasti ishte konsideruar si vetëvrasje, por ekspertët mjeko-ligjorë arritën në konkluzionin se ajo ishte mbytur me duar nga një person. Më datën 7 prill 2017, nën akuzë u vu Sadetin Sula, i cili akuzohet për "vrasje me dashje për shkak të marrëdhënieve familjare". Motivi i vrasjes dyshohet se ka qenë xhelozia. Por në zbulimin e mënyrës se si u krye krimi ndihmuan tabulatet telefonike. Nga to rezultoi se Sadetin Sula fliste shpesh me punëtorin Karmeshtna për gruan e tij dhe xhelozinë. Vrasja, që u cilësua më parë si vetëvrasje, u kryе nga Fatjon Karmeshtna me urdhër të këtij të fundit. Biznesmeni i Sulës. 35-vjeçari punonjës i mobilierisë, sipas prokurorisë, ka mbytur gruan e pronarit Sadetin Sula, me urdhër të këtij të fundit. Biznesmeni i frikësohej divorcit për përgjysmimin e pasurisë dhe akuzonte bashkëshorten për tradhti.

## Përfundojnë hetimet për ngjarjen e 10 gushtit 2018, dosja çohet në gjykatë

# Masakra e Selenicës, prokuroria: Të dënohet me burg përjetë Ridvan Zykaj

## *I riu vrau me kallash 8 kushërinjtë e tij*

**VLORË**

Prokuroria e Vlorës ka mbyllur hetimet dhe ka çuar në gjykatën e këtij rrethi dosjen në ngarkim të Ridvan Zykës, i cili akuzohet për vrasjen e tetë personave në fshatin Selenicë. Pas kryerjes së hetimeve, organi i akuzës kërkon dënimin me burg të përjetshëm të autorit të kësaj masakre. Mësohet se dënimi burg përjetë kërkohet nga prokurori Saimir Smaka. Ngjarja për të cilën akuzohet Zykaj ndodhi në gusht të vitit 2018, ku ai vrau 8 anëtarë të një familje në Selenicë, të cilët i kishte kushërinj të dytë.

**NGJARJA**

Më 10 gusht, 24-vjeçari Ridvan Zykaj u largua nga dreka familjare e me pas në gjendje "amoku" iu drejtua banesave të kushërinjve, ku qëlloi pa mëshirë mbi pleq e fëmijë, duke kryer masakrën e pashembullt. Zykaj pasi rrëmbeu një kallashnikov në dorë, ka shkuar në drejtim të banesave të kushërinjve të tij. Si fillim ai ka hyrë në oborrin e banesës së Besim Zykajt, ndërsa e ka gjetur kryefamiljarin aty dhe më pas ka hapur zjarr ndaj tij. Ai ka vrarë si fillim Besimin dhe gruan e tij, Vasilikën. Dora gjakatare e 24-vjeçarit ka shtënë edhe ndaj vajzës së Besimit, Sarës, 17 vjeçe, e cila qëndronte pak më larg prindërve dhe vëllain e saj të mitur, Ledjonin, vetëm 6 vjeç. Pasi ka shuar familjen e parë, Ridvani ka ecur në drejtim të banesës së Demirit, (vëllait të gjyshit) ndërsa e ka vrarë atë teksa qëndronte në divan në ballkonin e shtëpisë, dhe më pas ka shtënë në drejtim të gruas së tij, duke e lënë dhe atë të vdekur në vend. Ndërkohë, djali i Demirit, Azemi, pasi ka dëgjuar të shtënat me armë, ka dalë i tronditur bashkë me gruan për të parë se çfarë po ndodhte dhe iu drejtuan shtëpisë se babait, por janë vrarë me breshëri plumbash të dy bashkë në rrugë. Pas masakrës 24-vjeçari u arratis, ndërsa në ndjekje të tij u vunë rreth 500 efektivë të forcave speciale RENEA, FNSH dhe Delta Force. Zykaj u vu në pranga në të gdhirë të 13 gushtit. Në fshatin e tij ai njihej si një person problematik. Armën e krimit tip kallashnikov, Zykaj e ka pasur në banesën e tij dhe nga deklarimet në polici ai është shprehur se arma ishte siguruar gjatë vitit 1997 dhe që nga ajo kohë e mbante të fshehur në kasollen e bagëtive. Në atë kohë, edhe gjatë marrjes në pyetje nga prokurori, i riu ka qenë krejt i ftohtë dhe nuk ka shfaqur në asnjë moment pendesë. "I vrava se ata më akuzonin për grabitjet e pulave. Më akuzonin shpesh. Kemi pasur edhe konflikte të tjera edhe më përpara, pikërisht për këtë fakt. Ata vazhdimisht më akuzonin vetëm mua për grabitjet. Edhe më përpara kemi pasur konflikte, jo vetëm para vrasjes", është shprehur 24-vjeçari gjatë marrjes në pyetje nga prokurori.





Ridvan Zyka në sallën e gjyqit

**VIKTIMAT E MASAKRËS**

1- **Demir Zykaj,** 75 vjeç (vëllai i gjyshit të autorit)
2- **Ferie Zykaj,** 72 vjeçe, (gruaja e Demirit)
3- **Besim Zykaj,** 42 vjeç (djali i Demirit)
4- **Vasilika Zykaj,** (gruaja e Besimit)
5- **Sara Zykaj,** 17 vjeçe (vajza e Besimit)
6- **Ledjon Zykaj,** 6 vjeç (djali i Besimit)
7- **Azem Zykaj** (djali i Demirit)
8- **Afërdita Zykaj** (gruaja e Azemit)

## SHKURT

### "Shullazi", shtyhet seanca në Gjykatën e Apelit

**TIRANË** - Është shtyrë seanca në Gjykatën e Apelit për Emiljano Shullazin, Gilmando Danin, Endrit Qyqon, Endrit Zelen dhe Blerim Shullazin. Shkak i shtyrjes së seancës është bërë mungesa e dy prej avokatëve mbrojtës të të pandehurave, ndërsa seanca e radhës pritet të zhvillohet pas dy javësh. Gjithashtu, prokurori i Apelit për Krime të Isa Jata, do vazhdojë ta ndjekë këtë proces për arsye se Artan Bajrami u shkarkua nga KPK. Dy muaj më parë Krimet e Rënda dënuan me 55 vite burg Emiljano Shullazin, Gilmando Danin, Endrit Qyqja dhe Endrit Zela si dhe Blerim Shullazin. Për Shullazin u dha 14 vite burg, ndërsa ai bashkë me bandën e tij akuzohen për krijim të grupit të strukturat kriminal, gjobëvënie dhe kanosje për shkak të detyrës.

### Armë e drogë në makinë, arrestohen katër persona

**TIRANË** - Katër persona kanë rënë në prangat e Policisë së Shtetit për armëmbajtje pa leje, posedim lëndësh narkotike dhe aktivitetin e paligjshëm të lojërave të fatit. Përveç të arrestuarve të paktën 4 të tjerë janë proceduar penalisht, ndërsa një pjesë e madhe e denoncimeve janë bërë nga vetë qytetarët. Në mesin e të arrestuarve është edhe një 22 vjeçar nga Puka, i cili lëvizte në makinën e tij me kallashnikov. Në Librazhd është arrestuar një 49-vjeçar, të cilit i janë sekuestruar 14 fishekë si dhe 7 kg kanabis. Në Vlorë është arrestuar 36-vjeçari me iniciale S.D., të cilit i është sekuestruar kanabis. Në Lezhë, policia prangosi 50-vjeçarin me iniciale R.G., të cilit i janë gjendur në banesë 1.5 kg lëndë narkotike.

### Sekuestrohen 20 celularë në burg

**FIER** - Punonjësit e sigurisë në burgun e Fierit kanë sekuestruar rreth 20 celularë të markave të ndryshme, të cilët u tentuan të futeshin brenda ambienteve të burgut të fshehura nëpërmjet portave të mini-futbollit. Kapja e telefonave celularë u arrit nga punonjësit e sigurisë të burgut të Fierit, të cilët gjatë kontrollit të imtësishëm, arritën të zbulonin se brenda portave të mini futbollit ishin fshehur telefona celularë. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve njofton se materialet i kanë kaluar prokurorisë për hetime të mëtejshme.

**Njoftim për shitje me ankand te III**

Shoqëria "Power & Justice" (P&J) sh.p.k ka shpallur ne date 11.02.2019 ankandin e trete të pasurisë të palës debitore Shoqëria "G P R A" sh.p.k, e përbërë nga :
Pasurie Nr.31/33, ne Z K Nr. 2255, volum nr.5, faqe 235, me siperfaqe totale 7033 m2, ne Koxhas, Durres Ankandi i III fillon me çmim fillestar ne masen 103.077, 09 Euro.
Pasurie Nr.31/4, ne Z K Nr. 2255, volum nr.1, faqe 212, me siperfaqe totale 12 900 m2, ne Koxhas, Durres. Ankandi i III fillom me cmim fillestar ne masen 189.066,5 Euro .
Pasurie Nr.31/3, Z Ke Nr. 2255, volum nr.1, faqe 219, me siperfaqe totale 4 300 m2, ne Koxhas, Durres Ankandi i III fillon me çmimin fillestar ne masen. 63.022,1 Euro.
Ankandi do të zhvillohet në datë 13.03.2019 ora 15:00 në selisë Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr.5 Kontakt tel. 0672082543, ilir_dervishaj@yahoo.com, WEB www.powerjustice-al.com.

**Njoftim për shitje me ankand te III**

Shoqëria "Power & Justice" (P&J) sh.p.k ka shpallur ne date 11.02.2019 ankandin e trete të pasurisë të palës debitore Sh "Stati Construction " sh.p.k dhe e pales dorezanese, e përbërë nga :
"Are ", me numer pasurie 172/23 ne Zonen Kadastrale Nr. 1522, volumi 3, faqe 249, Ankandi fillon me çmim fillestar në masën 2.016.000 lekë
"Apartament ", me numer pasurie 116/61-1-19 Zonen Kadastrale Nr. 2291, volumi 22, faqe 42, , Ankandi fillon me çmim fillestar në masën 957.600 lekë
"Apartament ", me numer pasurie 116/61-1-20 Zonen Kadastrale Nr. 2291, volumi 23, faqe 43, Ankandi fillin me çmim fillestar në masën 1.713.600 lekë
Ankandi do të zhvillohet në datë 13.03.2019 ora 15:00 në selinë Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr.5 Kontakt tel. 0672082543, ilir_dervishaj@yahoo.com, WEB www.powerjustice-al.com.

**NJOFTIM ANKANDI**

**Përmbaruesi Gjyqësor Lekë Dodaj** shpall ankandin e parë për pasurinë e paluajtshme të palës debitore, si më poshtë :
1. *Garazh* nr.68/55-G9, zona kadastrale 3292, volumi 25, faqe 39, *ndodhur në Seltë Tiranë në pronësi të* ***z.Besnik Abaz Hoshafi.***
**Çmimi me të cilën do të fillojë Ankandi i Parë është 5.681 *(pese mije e gjashteqind e tetedhjete e nje)* Euro.**
Ankandi zhvillohet në datën **05.03.2019, Ora 16.00** në zyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Lekë Dodaj në adresën *Rruga "Astrit Balluku", Ndërtesa 2, Hyrja 25, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*.
**Për kontakt:** ***067 39 00 666, dhe në adresë emaili leke_dodaj@hotmail.com.***

### Politika po "djeg" investimet, Crawford: Investitorët, të stepur nga destabiliteti

# Kriza politike tremb investitorët

## *Problem, edhe ndryshimet e shpeshta fiskale në vend*

Situata e trazuar politike në vend po step investitorët e huaj, të cilët kanë shfaqur interes për Shqipërinë. Alarmi është dhënë nga presidenti i Dhomës Amerikane të Tregtisë, Mark Crawford, sipas të cilit, destabiliteti ndikon negativisht në ekonomi dhe se investitorët e huaj vihen në "status" pritjeje. Drejtuesi i Dhomës Amerikane të Tregtisë preku edhe ndryshimet e shpeshta fiskale në vend, sipas të cilit favorizojnë ndjeshëm rajonin. Pak ditë më parë opozita zhvilloi një protestë masive përpara godinës së Kryeministrisë, ndërsa pritet që të mos përfaqësojë më votuesit në parlament, duke djegur mandatet.

Tensionet politike dhe pasiguria sjellin efekte negative për thithjen e investimeve të huaja në Shqipëri. Një ditë pas deklaratës së opozitës për lënien e mandateve të deputetëve, Mark Crawford, presidenti i Dhomës Amerikane të Tregtisë shprehet se mungesa e stabilitetit është gjithmonë një minus në aspektin ekonomik. Sipas tij, politika duhet të bëjë kujdes për imazhin që krijon. "Çdo gjë që jep stabilitet është një plus. Çdo gjë që krijon një ambient që nuk është stabël është një minus. Investitorët thonë 'OK', nuk do nuk do investojnë, por do presin. Jam i shqetësuar për ata që nuk do vijnë këtu. Ky është imazhi që duhet të kujdesen politikanët", - thotë Mark Crawford. Rreziku i largimit të investitorëve të huaj është edhe më i dukshëm në një kohë kur vendet e Ballkanit kanë nisur politika favorizuese për ta. Madje, përfaqësuesi i biznesit amerikan në Shqipëri pranon se vendet e rajonit mbeten më tërheqëse. "Të paktën të jemi konkurrentë me rajonin, sepse nëse në Shkup ose në Prishtinë është më stabël, njerëzit do shkojnë ku është më stabël", - deklaron Mark Crawfrod. Kjo deklaratë erdhi pas një takimi që Dhoma Amerikane e Tregtisë zhvilloi me komisionerin për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale në vend.

**INVESTIMET**

Investimet e huaja arritën në 266 milionë euro në tremujorin e tretë të vitit, duke rënë me 9.2% në raport me të njëjtën periudhë të 2017-ës. Të dhënat e reja të publikuara nga Banka e Shqipërisë bënë të ditur se efektin kryesor në këtë rënie e ka dhënë pikërisht energjia, sektori që vitet e fundit ka udhëhequr rritjen e investimeve të huaja. Investimet në energji zbritën në 101 milionë euro për periudhën korrik-shtator, nga 194 milionë euro në të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke rënë me 47%. Rënia e investimeve në energji është kompensuar nga rritja e tyre në dy sektorë, atë të industrisë nxjerrëse, me 41%, duke arritur në 55 milionë euro. Sektori i dytë që ka parë zgjerim të lartë është ai i aktiviteteve të pasurive të paluajtshme, me 138%, në 31 milionë euro. Për 9- mujorin, investimet e huaja në total 758 milionë euro, me një rritje prej 12%, si rrjedhojë e performancës së mirë të sektorit të energjisë në tremujorin e parë të vitit, ndërsa në dy tremujorët e tjerë investimet ishin në rënie. Në tremujorin e parë, investimet në energji arritën në 182 milionë euro, si rrjedhojë e punimeve të vështira që u bënë në zonën e Skraparit për shkak të tubave të gazsjellësit TAP, që u shtruan nën lumenj. Në total për 9-mujorin, investimet në energji arritën në 387 milionë euro, duke përbërë 51% të totalit dhe duke e lënë vendin të varur nga ecuria e tyre, ndërkohë që në 2019-ën, projekti i gazsjellësit TAP pritet të përfundojë.



Presidenti i Dhomës Amerikane të Tregtisë, Mark Crawford

**EKSPOZITA**

Rënia e investimeve në energji është kompensuar nga rritja e tyre në dy sektorë, atë të industrisë nxjerrëse, me 41%, duke arritur në 55 milionë euro. Sektori i dytë që ka parë zgjerim të lartë është ai i aktiviteteve të pasurive të paluajtshme, me 138%, në 31 milionë euro. Për 9-mujorin, investimet e huaja në total 758 milionë euro, me një rritje prej 12%, si rrjedhojë e performancës së mirë të sektorit të energjisë në tremujorin e parë të vitit, ndërsa në dy tremujorët e tjerë investimet ishin në rënie.



## Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare krijon platformën e re 'online' për ankesat e qytetarëve

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, duke nisur nga data 18 shkurt 2019, ka filluar zbatimin e një regjistri të ri si një platformë për depozitimin e ankesave të konsumatorëve. "Platforma 'online' e ankesave të qytetarëve krijon mundësinë për çdo konsumator dhe individ të depozitojë problematikën e tij për veprime dhe detyrime që lindin nga aktiviteti i operatorëve ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në tregjet financiare jobankare, nën mbikëqyrjen e AMF-së. Kjo platformë është një mundësi e re për qytetarët, jo vetëm për të paraqitur shqetësimet e tyre, por edhe për të ndjekur më tej ecurinë hap pas hapi të problematikës së paraqitur, për të arritur deri në zgjidhjen përfundimtare të saj", njofton AMF. Fillimi i kësaj platforme të re, sipas AMF-së, është një mundësi më shumë që u ofrohet qytetarëve për të trajtuar dhe zgjidhur problemet e tyre, duke realizuar kështu një nga misionet kryesore të punës së Autoritetit.

> **PLATFORMA 'ONLINE'**
> Kjo platformë është një mundësi e re për qytetarët, jo vetëm për të paraqitur shqetësimet e tyre, por edhe për të ndjekur më tej ecurinë hap pas hapi të problematikës së paraqitur.

## DPT: Ndërpritet mbledhja me forcë kur tatimpaguesit janë falur me ligj



**DPT**

Për të gjithë ata tatimpagues, ndaj të cilëve Administrata Tatimore ka kërkuar fillimin e një procedure falimentimi, publikohen informacionet përkatëse në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Administrata Tatimore do të ndërpresë masat shtrënguese për sigurimin e pagimit të detyrimit tatimor, në rastet kur tatimpaguesi e ka paguar të gjithë detyrimin e tij tatimor, kur tatimet janë falur me ligj nga ana e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe kur sipas përcaktimit në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, është vendosur dhe shpallur detyrimi tatimor i pambledhshëm. Deklarimi i detyrimeve tatimore si të pambledhshme është procesi, i cili kryhet vetëm në raste ekstreme dhe nuk është arritur të mblidhet dhe të arkëtohet detyrimi tatimor. Detyrimi tatimor mund të deklarohet i pambledhshëm vetëm në rastet e mëposhtme: Kur megjithëse është bërë shitja e investimeve likuide dhe aktiveve të tjera, nuk është bërë i mundur arkëtimi i detyrimit, kur tatimpaguesi në bashkërendim me Administratën Tatimore provojnë me evidencë të saktë se tatimpaguesi nuk disponon asnjë lloj pasurie apo të ardhure, që do të mund të përdorej për shlyerjen qoftë edhe me këste të detyrimit tatimor të papaguar dhe kur pas analizës së situatës financiare dhe pasurore të subjektit tatimpagues, Administrata Tatimore arrin në përfundimin se shitja e pasurisë së tatimpaguesit, ndaj të cilit do të fillonte një procedure likuidimi apo falimentimi, nuk do të shlyente shumën e detyrimit tatimor. DPT ka kërkuar që tatimpaguesit të jenë të kujdesshëm, sepse që detyrimi tatimor të deklarohet i pambledhshëm, duhet që të tria arsyet më lart të plotësohen në mënyrë të njëkohshme. Për sa i përket fillimit të procedurave të falimentimit, bëhet në gjykatë nga ana Administratës Tatimore në përputhje me ligjin nr.110/2016 "Për falimentimin". Administrata Tatimore në të cilën është regjistruar tatimpaguesi, ose në juridiksionin e të cilës ushtrohet veprimtaria ekonomike e tatimpaguesit, ka detyrimin të kërkojë në gjykatën kompetente, fillimin e procedurave të falimentimit. DPT thotë se për të gjithë ata tatimpagues, ndaj të cilëve Administrata Tatimore ka kërkuar fillimin e një procedure falimentimi, publikohen informacionet përkatëse në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Ndërtimet e paligjshme, miratohet fondi, formulari për të marrë kompensimin

# Lista e re, 750 pronarët që marrin 552 milionë lekë

## Përfituesit në Tiranë, Elbasan, Vlorë, Durrës, Shkodër, Korçë

Publikohet lista me 750 pronarë që do të marrin kompensimin e pronarëve që u është zënë toka nga ndërtimet pa leje. Fondi i vënë në dispozicion është rreth 552 milionë lekë. Bëhet fjalë për ndërtimet pa leje në drejtoritë për ALUIZNI-t, përkatësisht në Tiranë Veri, Elbasan, Tiranë Jug, Tiranë Shtesat, Vlorë, Durrës, Shkodër, Korçë, Kukës, Kavajë, Fshatra Turistikë dhe Kamëz, Vorë. Referuar vendimit të Këshillit të Ministrave, vlera e kompensimit për 43 920,53 m2 është 522 842 426,65 lekë. ATP publikon edhe formularin që duhet të plotësojnë përfituesit për të marrë kompensimin. "Gazeta Shqiptare" publikon listën me përfituesit në gjithë vendin.

**VENDIMI**

Në vendim përcaktohet se për kompensimin e pronarëve përdoren po ato të ardhura që arkëtohen nga ALUIZNI si rrjedhojë e kalimit të pronësisë ndërmjet shitjes së parcelës ndërtimore si për pasuritë shtetërore, edhe për pasuritë e të tretëve, në favor të objekteve informale që legalizohen. Qeveria përcakton se për kompensimin e pronarëve përdoren po ato të ardhura që arkëtohen nga ALUIZNI, si rrjedhojë e kalimit të pronësisë nëpërmjet shitjes së parcelës ndërtimore, si për pasuritë shtetërore, edhe për pasuritë e të tretëve, në favor të objekteve informale që legalizohen. "Zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, përkatësisht, në Tiranë, Elbasan, Durrës, Vlorë, Korçë, Kukës, Kavajë dhe Shkodër të kryejnë ndryshimet përkatëse për këto pasuri, në regjistrat e pasurive të paluajtshme", përcakton më tej vendimi. Ndërkohë ngarkohen Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Agjencia e Trajtimit të Pronës, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi".



FORMULAR APLIKIMI
KOMPENSIM FINANCIAR PËR PRONARËT E PASURIVE TË PALUAJTSHME QË PREKEN NGA LEGALIZIMI I NDËRTIMEVE INFORMALE
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE
MINISTRIA E DREJTËSISË

Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni:
Tel: (+355) 42 22 56 831 / 38
E-mail: info.atp@atp.gov.al
Web: www.atp.gov.al

HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN

Shënim: ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë, ME SHKRONJË TË MADHE E NË NGJYRË BLU.

SEKSIONI A: INFORMACION MBI APLIKANTIN

1. Emri — 2. Mbiemri
3. Emri i Babait — 4. NID (Nr. i identifikimit personal)
5. Gjinia: Mashkull / Femër — 6. Datëlindja (Data, Muaji, Viti)
7. Vendlindja — 8. Shtetësia
9. Adresa
10. Qyteti — 11. Rrethi
12. Kodi Postar — 13. E-mail
14. Nr. Tel. Celular — 15. Nr. Tel. Fiks

SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN

16. Subjekti përfitues
Emri — Emri i Babait
Mbiemri
Emri — Emri i Babait

17. Përfaqësuesi me prokurë i subjektit përfitues që paraqet kërkesën
Emri — Emri i Babait
Mbiemri

18. Adresa e subjektit përfitues ose e përfaqësuesit të tij me prokurë
Adresa
Qyteti — Rrethi
Kodi Postar — E-mail
Nr. Tel. Celular — Nr. Tel. Fiks

"Në përputhje me nenin 15/1 të ligjit Nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, nenit 24 i ligjit 133/2015 "Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave", si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 383, datë 19.05.2010 "Për përcaktimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimet informale".

Në listën bashkëlidhur Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. ______ datë (Data, Muaji, Viti) mbaj numrin rendor nga ______ deri ______

SEKSIONI C: DOKUMENTACIONI I PARAQITUR

- Kërkesa për kompensimin e pronës sipas formatit Tip (i cili mund të shkarkohet nga faqja zyrtare e internetit e ATP-së -www.atp.gov.al)
- Dëshmia e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfitues sipas radhës së trashëgimtarëve në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil. Për dëshmitë e trashëgimive të lëshuara nga gjykata për testamentin e bërë me akt noterial, të sillet certifikatë familjare e personit për të cilin është lëshuar kjo dëshmi trashëgimie
- Prokurën e posaçme të nënshkruar nga të gjitha subjektet që përfitojnë kompensim ku, si tagër i nevojshëm të jetë edhe e drejta për të tërhequr vlerën financiare në emër të tyre
- Vërtetimin e lëshuar nga banka e nivelit të dytë për hapjen e llogarisë bankare në emër dhe për llogari të subjektit përfitues, ku përcaktohet edhe numri i llogarisë bankare ku do të transferohet vlera financiare e përfituar
- Fotokopje të dokumentit të identifikimit si dhe certifikatën familjare të kërkuesit
- Mandatpagesa që vërteton pagimin e tarifës së shërbimit

Nënshkrimi i Aplikantit — (Data, Muaji, Viti)

KLAUZOLA DEKLARATIVE

Unë i/e nënshkruari/a ______ në dijeni të përgjegjësive penale që rrjedhin nga deklarimi dhe paraqitja e të dhënave e rrethanave të rreme, nën përgjegjësinë time personale deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta.

Nënshkrimi i Aplikantit — (Data, Muaji, Viti)

Faksimile e formularit të aplikimit

**APLIKIMI**

Procesi i regjistrimit apo pranimit të kërkesave për kompensim fillon 5 ditë pas datës së njoftimit publik. Me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të ATP-së ngrihet grupi i punës për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave, me objekt shpërblimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimet informale dhe shpërndarjen e fondit përkatës. Grupi i punës brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për kompensimin e pronës kryen verifikimet e duhura. Drejtori i përgjithshëm i ATP-së brenda 30 ditëve nga data e përfundimit të procesit të verifikimit nga grupi i punës nxjerr vendimin me emrat e subjekteve që përfitojnë nga kompensimi dhe urdhëron publikimin e listës së subjekteve që kompensohen. Gjithashtu, ai njofton edhe aplikantët që nuk përfshihen në listën e subjekteve që kompensohen, duke përcaktuar arsyet e mospërfshirjes. Subjekti apo përfaqësuesi i tij me prokurë duhet të paraqesë pranë ATP-së, Tiranë, kërkesën-tip që i vihet në dispozicion nga grupi i punës pranë AKKP-së, të plotësuar sipas rubrikave. Në listën e dokumenteve është dëshmia e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfitues, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil. Sipas ligjit, për dëshmitë e trashëgimive të lëshuara nga gjykata për testamentin e bërë me akt noterial të sillet certifikatë familjare e personit për të cilin është lëshuar kjo dëshmi. Një tjetër dokument është prokura e posaçme, e nënshkruar nga të gjitha subjektet që përfitojnë kompensim. Në rastin e kërkesave individuale të secilit bashkëpronar apo të një pjese të tyre, për çdo aplikim të kryer, paguhet tarifë shërbimi në vlerën 2 000 lekë, pavarësisht se i përket të njëjtës pasuri të paluajtshme.

### DOKUMENTAT

Aplikimi për të marrë paratë dhe dokumentet ATP-ja në zbatim të VKM nr. 383/2010 **"Për përcaktimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale" i ndryshuar, procedon si më poshtë:**

**1.** NjoftON publikisht në media dhe/ose nëpërmjet faqes zyrtare, listën e personave që përfitojnë nga fondi i kompensimit të pronave, për periudhën përkatëse.

**2.** Procesi i regjistrimit/pranimit të kërkesave për kompensim fillon 5 (pesë) ditë pas datës së njoftimit publik.

**3.** Subjekti apo përfaqësuesi me prokurë paraqet pranë ATP-së gjithë dokumentacionin e lartpërmendur.

**4.** Me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të ATP-së ngrihet grupi i punës për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave me objekt shpërblimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimet informale dhe shpërndarjen e fondit përkatës.

**5.** Grupi i punës, brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për kompensimin e pronës, kryen verifikimet e duhura.

**6.** Drejtori i përgjithshëm i ATP-së, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e përfundimit të procesit të verifikimit nga grupi i punës: a) nxjerr vendimin me emrat e subjekteve që përfitojnë nga kompensimi; b) urdhëron publikimin e listës së subjekteve që kompensohen; c) njofton kërkuesin që nuk përfshihet në listën e subjekteve që kompensohen, duke përcaktuar arsyet e mos përfshirjes.

| Kompensimi i Pronarëve | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Emër | Atësi | Mbiemër | Shuma - Vlera e kompensimit (lek) |
| | REFIK | IDRIZ | SHEHI | 74,852.70 |
| | SUZANA | THOMA | PERIHANA | |
| | SADETE | SABRI | PERIHANA | |
| | BLERTA | HALIT | PERIHANA | |
| | ALESIO | IBRAHIM | PERIHANA | |
| | VALBONA | AGIM | PERIHANA | |
| | FITNETE | MUSA | PERIHANA | |
| | DELINA | HYSNI | PERIHANA | |
| | GANI | DEMIR | LULJA | |
| | RUDINA | DEMIR | LULJA | |
| | SUZI | HAMIT | BEGEJA | |
| | SAIMIR | SAMI | PERIHANA | 1,001,717.80 |
| | DANE | | STRINGA | |
| | LUAN | | STRINGA | |
| | ARFA | | GARUNJA | |
| | HAXHIRE | | STRINGA | |
| | NEXHMIJE | | BORIÇI | |
| | ENGJELLUSHE | | STRINGA | |
| | XHAFERR | | MUSAI | |
| | ASIME | | SERJANI | |
| | PERPARIM | | SERJANI | |

| Kompensimi i Pronarëve | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Emër | Atësi | Mbiemër | Shuma - Vlera e kompensimit (lek) |
| | JASIN | | SERJANI | |
| | TELHA | | SERJANI | |
| | ADRIATIK | | SERJANI | |
| | DURIM | | URUPI | |
| | ALIJE | | GURRA | |
| | NASHIFER | | SHQERRA | |
| | PRANVERA | | ÇAKA | |
| | BEQIR | | URUPI | |
| | EDUART | | DUSHKU | 1,645,279.60 |
| | 10 | 11 | 12 | 17 |
| | REFIK | IDRIZ | SHEHI | 74,852.70 |
| | SUZANA | THOMA | PERIHANA | |
| | SADETE | SABRI | PERIHANA | |
| | BLERTA | HALIT | PERIHANA | |
| | ALESIO | IBRAHIM | PERIHANA | |
| | VALBONA | AGIM | PERIHANA | |
| | FITNETE | MUSA | PERIHANA | |
| | DELINA | HYSNI | PERIHANA | |
| | GANI | DEMIR | LULJA | |
| | RUDINA | DEMIR | LULJA | |

VIP Pages
Suplement
E mërkurë 20 Shkurt 2019 GAZETA SHQIPTARE Redaktore: Pamela Aliaj

## "BULEVARDI POLITIK"

- •Ramës i kërkojnë "dorën" e Zahos për dhëndër në Pukë, por kryeministri refuzon
- •Ditmir Bushati, i lumtur që kthehet në Komisionin e Jashtëm, por kësaj here si deputet
- •Qentë i prishin fjalimin, situata e sikletshme e Vuçiçit
- •Deputeti, dedikim të birit: Ndjejmë emocion si atë natë kur erdhe...

## Jonida Maliqi dhe Erion Veliaj zbulojnë surprizën e "Eurovizionit"



## Imitoi fustanin në shfaqjen në Kosovë, Zaimina Vasjari thumbon me stil Luanën



Flet muzikanti i Orkestrës Simfonike të RTSH: Vendet nordike më kanë lënë mbresa të veçanta



# Arbër Neziri: Si lindi dashuria për muzikën

*"Rrugëtimi ka qenë goxha i vështirë, sepse duhet të bësh shumë sakrifica në një moshë të vogël"*

Flet muzikanti i Orkestrës Simfonike të RTSH: Vendet nordike më kanë lënë mbresa të veçanta

# Rrëfehet Arbër Neziri:

## Si lindi dashuria për muzikën dhe pasionet e tjera të jetës sime

*"Rrugëtimi ka qenë goxha i vështirë, sepse duhet të bësh shumë sakrifica në një moshë të vogël"*





Pamela Aliaj

Ne kemi shumë asete të veçanta dhe unike në kulturën tonë që na bëjnë të shquhemi dhe të dallohemi ndër vendet e tjera fqinje dhe kudo që marrim pjesë, zëmë një vend të veçantë falë talenteve që ne nxjerrim. Jo shumë shpesh na ndodh të ndjekim një shfaqje të dhënë me shumë mjeshtëri nga orkestra jonë dhe aq më tepër të jemi mësuar me kulturën e muzikës klasike. Ai është një nga pjesëtarët e veçantë të Orkestrës Simfonike të RTSH. Arbër Neziri, mjeshtër i veglës muzikore korno, vjen në një rrëfim për "Vip Pages" te "Gazeta Shqiptare" për të na folur më tepër rreth magjisë së skenës, që ai përjeton si në Shqipëri apo edhe në Etymos Asamble në Itali, ku ai bën pjesë. Sa e vështirë është rruga për të arritur deri këtu si dhe shumë element të panjohur që qëndrojnë pas kuintave të jetës së një muzikanti i zbuloni në intervistën e mëposhtme.

**Si nisi pasioni për muzikën?**

Pasioni për muzikën lindi shumë herët, rreth moshës 5-6 vjeçare dhe e çuditshme për atë moshë dëgjoja shumë muzikë klasike. Megjithatë, vetëm në moshën 10-vjeçare hyra në Liceun Artistik.

**Sa i vështirë ka qenë rrugëtimi deri këtu ku keni arritur?**

Rrugëtimi ka qenë goxha i vështirë, sepse duhet të bësh shumë sakrifica në një moshë të vogël për t'ju dedikuar studimit. Por, periudha më e vështirë ka qenë kur shkova për të vazhduar studimet në konservator në Itali dhe isha vetëm 15 vjeç.

**Ju jeni pjesë e Orkestrës Simfonike të Radio Televizionit Shqiptar. A merrni pjesë diku tjetër?**

Unë jam pjesë e Orkestrës Simfonike të Radio Televizionit Shqiptar gjithashtu edhe në Itali jam pjesë e Etymos Ansamble nën drejtimin e kompozitorit italian Girolamo Deraco.

**Keni pasur propozime nga vende të tjera? Kush ju ka lënë mbresa?**

Kam pasur shumë bashkëpunime dhe më kanë lënë goxha mbresa vendet nordike, sepse e zhvillojnë shumë zhanrin e muzikës klasike bashkëkohore.

**Kush ka qenë personi që ju ka nxitur të ndërmerrni këtë rrugë?**

Nuk ka pasur një person në veçanti, që më ka nxitur të ndërmarr këtë profesion. Ka qenë diçka e natyrshme. Por mund të them që në instrumentin e kornos më ka afruar profesori im i kornos, Avni Dajko.

**Përveç kornos, keni ndonjë vegël tjetër muzikore që e keni të preferuar?**

Përveç kornos, më tërheq shumë dirigjimi që kam filluar ta studioj dhe të praktikohem nga pak.

**Në pjesëmarrjet tuaja jashtë vendit kush ju ka lënë emocione më të veçanta?**

Në pjesëmarrjet e mija jashtë shtetit mund të veçoj: Requiem-in e Verdit, në festivalin Anima Mundi në Pisa Itali me Orkestrën Rinore Shqiptare.

**Si është një ditë e zakonshme e Arbrit?**

Zgjohem goxha herët në mëngjes, shkoj në RTSH për të bërë studimin e mëngjesit përpara se të filloj provat me Orkestrën Simfonike të Radio Televizionit Shqiptar. Pas provave i dedikohem Fondacionit IDEA (fondacion kulturor italo-shqiptar), të cilën e drejtoj prej disa vitesh.

**A keni ndonjë pasion tjetër veç muzikës?**

Përveç muzikës kam pasion sportin si dhe sartorinë, kostumet të cilat i bëj të gjitha me porosi. Pasion të cilin e kam që prej kohës së studimeve në Firence.

**Së fundmi jeni në një udhëtim në Itali. A keni menduar të zhvendoseni dhe ta zhvilloni aty pasionin tuaj?**

Po këto ditë jam në Itali për disa aktivitete. Për momentin, një pjesë të vitit e kaloj në Itali për shkak të koncerteve dhe fondacionit IDEA, por në varësi të projekteve që do të kem, do të zgjedh edhe vendin se ku do ta zhvilloj profesionin tim.





Ditën e djeshme kryebashkiaku Erion Veliaj ka bërë të ditur surprizën e madhe që ka përgatitur prej ditësh në bashkëpunim me këngëtaren Jonida Maliqi. Krahas fotove me këngëtaren, kryetari i bashkisë së kryeqytetit ka njoftuar që këtë vit, Eurovizioni do përjetohet ndryshe në Shqipëri. "Kemi një surprizë të paparë me Jonida Maliqi për Eurovision! Teksa ajo shkon të na përfaqësojë në Izrael, ne do të kemi një festë mbështetëse të paparë në sheshin "Skënderbej". FORCA JONÇE",-ka shkruar ai, vetëm pak orë më parë. Këtë vit, përfaqësuese në festivalin e rëndësishëm europian do të jetë Jonida Maliqi me këngën 'Ktheju Tokës'. Përfaqësimi nga këngëtarja e njohur është pritur me shumë entuziazëm nga publiku dhe për të treguar mbështetjen ndaj saj, pritet që kjo nismë të mbështetet nga të gjithë qytetarët.





# Një frymë tjetër për 'Eurovizionin' këtë vit, ja surpriza e Jonida Maliqit dhe Erion Veliajt





Jo vetëm shtatzënia, por gjithçka lidhur me jetën private të VIP-ave, për
ndjekësit përbën gjithmonë një temë me mjaft interes. Por kur bëhet fjalë
për femra në moshë të madhe, kureshtja rritet akoma edhe më shumë. Ndaj
dhe fotoja e postuar nga Mihrije Braha në rrjetet sociale ngjalli interes të
menjëhershëm!! Këngëtarja shfaqej aty me një fustan elegant, por dhe një
bark të rrumbullakosur që bëri te lindtte menjëherë pyetja: është shtatzënë?
Ajo ka një djalë me bashkëshortin Naim Abazi, Platorin edhe pse shkenca tani
po bën çudira, Mihrija vetë sqaroi se bëhej fjalë thjesht për një shaka. Gjithç-
ka mund të ndodhë!

# I habit të gjithë këngëtarja shqiptare, shtatzënë 52-vjeçe?

Edhe pse është në fund të pritjes së ëmbël, Elita Rudi e ka mbajtur të fshehtë gjatë gjithë kësaj kohe gjininë e bebit. Ndërsa pak kohë më parë ndjekësit hodhën dyshimet se, Elita dhe Gjiko do të bëhen me një djalë, tashmë një video na bën të dyshojmë për të kundërtën. Moderatorja nga Kosova publikoi në 'Instagram' një video ku tregon rutinën e saj të makijazhit, por në një moment i hidhet një tullumbace ngjyrë rozë përpara. Vetë Elita vazhdon të luajë me të, para se ta largojë nga fushëpamja. Por kjo video u fshi nga profili i saj dhe tashmë ata që e panë mendojnë se fëmija që pritet të vijë në jetë do të jetë vajzë. Elita ka treguar se foshnjën do ta sjellë në jetë me lindje natyrale, ndërsa mësohet se çifti e ka zgjedhur dhe emrin e bebes. Të shohim a është djalë apo vajzë!





# Elita Rudi zbuloi pa dashje gjininë e foshnjës, fshin videon nga rrjetet sociale






Për ditëlindjen e parë të vajzës Zaimina Vasjari zgjodhi një fustan të
veçantë, i cili u përfol se ishte kopjuar në veshje nga Khloe Kardash-
ian. Fustani në pjesën e sipërme ka shpatullat e ekspozuara dhe është
me xixa dhe të gjithë menduan se ishte i frymëzuar nga fustani që Khloe
Kardashian veshi për festën e krishtlindjeve. Ndërkohë së fundmi,
moderatorja Luana Vjollca gjatë një koncertit për Pavarësinë e Kosovës,
u shfaq e veshur njëlloj si Zaimina, veçse pjesa e poshtme ishte e
bardhë. Në një postim në 'Instastory', bashkangjitur me foton e saj nga
ditëlindja e së bijës, Zaimina ka vënë edhe një emoji me shprehi ironike
që të gjithëve po iu lë përshtypjen që i drejtohet Luana Vjollcës. Ta këtë
drejtpërdrejtë me Luanën këtë shprehi?

# Imitoi fustanin në shfaqjen në Kosovë, Zaimina Vasjari thumbon me stil Luanën

BULEVARDI POLITIK
*Na merrni seriozisht!*

## Ramës i kërkojnë "dorën" e Zahos për dhëndër në Pukë, por kryeministri refuzon

Kryeministri Edi Rama ishte dje në Pukë ku vijoi turin e tij të takimeve publike "Bashkia që duam". E krahas pjesës serioze të diskutimit për problematikat lokale dhe politikën, edhe gjatë këtij takimi nuk munguan batutat e kryeministrit me banorët e Pukës. Një qytetare i tha kryeministrit se djalin e tij të vogël Zahon do ta bëjnë dhëndër Puke, çka solli jo pak të qeshura në takim. "Zahon do ta bëjmë dhëndër Puke se ti na do dhe na respekton",-tha qytetarja në këtë takim. Por kryeministri Rama duke iu përgjigjur po ashtu me humor kësaj kërkese i tha qytetares se këtë gjë nuk e premton dot. Jo për gjë, por kryeministri sa herë që e jep fjalën e mban, ndaj kësaj here s'ka dashur të rrezikojë shumë. "Po të isha si politikanët e tjerë do thosha patjetër, por unë nuk jam si politikanët e tjerë dhe këtë nuk ta premtoj dot. Shaka, shaka, por këtë nuk e premtoj dot", - tha Rama.






## Qentë i prishin fjalimin, situata e sikletshme e Vuçiçit

Presidentin serb nuk e lënë rehat as qentë. Një situatë sa e sikletshme aq edhe qesharake, i ka ndodhur Presidentit Serb Aleksandër Vuçiç gjatë kohës që ai po mbante një fjalim. Teksa ai po fliste, në sheshin mes tij, dhe të ftuarve dy qen po çiftoheshin. Edhe pse ishte një situatë mjaft e sikletshme Vuçiç, në kushtet kur nuk kishte çfarë të bënte, vetëm i injoroi.

## Ditmir Bushati i lumtur që kthehet në Komisionin e Jashtëm, por kësaj here si deputet

Pas më shumë se 1 muaj debat mes kryeministrit Edi Rama dhe presidentit Ilir Meta, Ditmir Bushati e la më së fundi detyrën e ministrit të Jashtëm duke u kthyer tashmë në një deputet i thjeshtë i Kuvendit të Shqipërisë. Ai ka hequr dorë tashmë nga previlegjet e ministrit dhe prej pak ditësh i është kthyer jetës parlamentare. Jo vetëm sa i përket angazhimit në seancë plenare ku numrat janë të nevojshëm, por së fundi edhe si anëtar i Komisionit të Jashtëm. Foto e mëposhtme është shkrepur dje nga mbledhja e Komisionit të Jashtëm, ku siç edhe duket Bushati është vërtetë i lumtur që tashmë është i pranishëm në këtë tryezë tashmë si deputet dhe jo si ministër, siç jemi mësuar ta shohim zakonisht.




## Deputeti, dedikim të birit: Ndjejmë emocion si atë natë kur erdhe...

Djali i deputetit të PS-së Pjerin Ndreu, Alvi, festoi ditëlindjen. Lajmin e dha vetë deputeti, i cili bëri një dedikim të veçantë, ku shprehet se Alvi bëri që si deputeti dhe bashkëshortja e tij Arlinda, të quheshin prindër. "Alvin bën sot 25. Ai na dha privilegjin i pari Arlindës dhe mua të quhemi prind. Familja jonë mori kuptim pikërisht 25 vjet më parë. Ne sot jemi krenar për birin tonë dhe ndjejmë emocion si atë natë kur erdhi për herë të parë në jetë. Duke i uruar edhe 100 dhe të gjitha të mirat e botës i themi se e duam pafund për grithsha ai përfaqëson si një i ri me virtyte dhe me sjellje model. Fundja një prind këtë do më së shumti prej fëmijëve të vet!", shprehet z.Ndreu.



BULEVARDI POLITIK
*Na merrni seriozisht!*

## ISHP, thirrje qytetarëve: Vaksinohuni sa më shpejt

# Shkon në 91 numri i të prekurve nga fruthi në të gjithë vendin

Që prej fillimit të këtij viti, numri i të prekurve nga fruthi në vendin tonë ka arritur në 91, duke krijuar kështu një situatë të rënduar. Shifrat janë bërë publike ditën e djeshme nga Instituti i Shëndetit Publik, i cili i ka bërë thirrje qytetarëve të vaksinohen sa më shpejt.

**NJOFTIMI I ISHP**

"Instituti i Shëndetit Publik u bën apel qytetarëve të bëjnë kujdes dhe të vaksinohen pasi vihet re se numri i rasteve të prekur nga fruthi është në rritje. ISHP bën me dije se për shkak se kjo periudhë e vitit sjell rritje të numrit të rasteve të infeksioneve respiratore dhe gripit, bëhet akoma më i rëndësishëm vaksinimi, për të parandaluar përhapjen e fruthit. ISHP informon qytetarët se për vitin 2019 numri i të prekurve me fruth është 91 raste (pozitive)",- thuhet në njoftimin e ISHP. Sipas të dhënave të ISHP grupmosha më e prekur është nën 2 vjeç. Numri më i lartë i rasteve 55 raste(60.4%) ndodhen në Tiranë, Lezha 10 raste(11%), Durrësi 7 raste(8%). ISHP thotë se për shkak se kjo periudhë e vitit sjell rritjen e rasteve të infeksioneve respiratore dhe gripit, bëhet akoma më e rëndësishëm vaksinimi i fëmijëve për të parandaluar përhapjen e fruthit



**ISHP**

"Instituti i Shëndetit Publik u bën apel qytetarëve të bëjnë kujdes dhe të vaksinohen pasi vihet re se numri i rasteve të prekura nga fruthi është në rritje. ISHP bën me dije se për shkak se kjo periudhë e vitit sjell rritje të numrit të rasteve të infeksioneve respiratore dhe gripit, bëhet akoma më i rëndësishëm vaksinimi, për të parandaluar përhapjen e fruthit. ISHP informon qytetarët se për vitin 2019 numri i të prekurve me fruth është 91 raste (pozitive)", - thuhet në njoftimin e ISHP. Sipas të dhënave të ISHP grupmosha më e prekur është nën 2 vjeç. Numri më i lartë i rasteve 55 raste(60.4%) ndodhen në Tiranë, Lezha 10 raste(11%), Durrësi 7 raste(8%).

**MASAT E NDËRMARRA NGA ISHP PËR MBROJTJEN NGA EPIDEMIA E FRUTHIT:**

- Izolimi në pavione të caktuara (në pediatri dhe tek të rriturit) dhe vetëizolimi për rastet ambulatore.
- Masa standarde të kontrollit të infeksionit dhe të transmetimit ajror.
- Përdorim i maskave nga personeli dhe pacientët kur shkojnë në ekzaminime.
- Vaksinim i personelit.
- Monitorim i gjendjes mbrojtëse të personelit ndaj Fruthit.
- Vaksinim brenda 72 orëve i kontakteve.
- Vendosja e survejancës aktive në nivel kombëtar.
- Trajnime me pjesëmarrjen e mjekëve të institucioneve parashkollore dhe shkollore si dhe mjekëve të familjes.
- Organizata Botërore e Shëndetësisë rekomandon vaksinimin e të gjithë fëmijëve si dhe të rriturve që janë në rrezik për t'u infektuar, për të cilët kryerja e vaksinës së fruthit nuk është e kundërindikuar.

## Përveç taksës së pastrimit, 480 lekë më shumë për çdo ton mbetje të dërguar në Sharrë

# Landfilli i Sharrës, tarifa shtesë bie në kurriz të konsumatorëve

## *Bashkia e Tiranës pranon ofertën e koncesionarit*

Për të hedhur mbetjet inerte në landfillin e Sharrës, kompani të ndryshme ndërtimi, kanë kontraktuar kamionë për të realizimin e këtij procesi. Ndërkohë, ashtu siç dihet, ky landfill është i vetmi vend në të gjithë kryeqytetin ku lejohet hedhja e dherave, apo materialeve që mbeten pas ndërtimeve. Kompanitë duhet të paguajnë një shumë prej 480 lekësh për tonë, apo rreth 100 euro për kamion. Pagesën duhet ta kryejnë edhe individë, të cilët kontraktojë mjete të tonazhit të ulët apo te lartë për zhvendosjen e mbetjeve inerte pas kryerjeve të punimeve të ndryshme në ambiente private. Tarifa është vendosur nga kompania "Integrated Energy B. V" e cila prej vitit 2017 ka fituar për 30 vjet koncesionin e menaxhimit të mbetjeve të gjithë kryeqytetit.

**TARIFA**

News24 ka arritur të mësojë se Bashkia e Tiranës është njoftuar dhe e ka pranuar propozimin e koncesionarit për të caktuar atë tarifë. Të gjithë këto fakte ngrenë dyshimet për një aferë në favor të vetë koncesionarit. Në bazë të kontratës së nënshkruar me Ministrinë e Mjedisit, kompania, e cila do të ndërtojë edhe inceneratorin, do të paguhet nga Bashkia e Tiranës me një shumë prej 29 eurosh për çdo tonë mbetje organike që depozitohet në landfill, nga mjetet që merren me pastrimin e kryeqytetit.

**SHTESAT PËR QYTETARËT**

Tani përpos kësaj shume, individë, apo kompani të ndryshme, të cilat e paguajnë një herë taksën e pastrimit do të duhet të paguajnë një tarifë prej 480 lekësh për çdo tonë mbetje të dërguar në Sharrë.

Dhe nuk mbaron me kaq. Bashkia e Tiranës me anë të Policisë Bashkiake dhe Inspektoratit Mjedisor nuk i lejojnë kompanitë që të mund t'i depozitojnë mbetjet ndërtimore apo dherat në vende të tjera me një çmim më të ulët. Madje as të mund t'i shesin ato për llogari të kompanive të tjera që mund të kenë nevojë për dherat e përfituara nga hapja e gropave të ndërtimit. Penalitetet e përcaktuara nga autoritetet nuk bëjnë gjë tjetër vetëm se i drejtojnë mjetet për në Sharrë, aty ku kompania koncesionare e shndërruar tashmë në monopoliste, do të vjelë para të tjera, përpos shumës së madhe që i paguan çdo muaj bashkia e kryeqytetit. Ndërkohë që tarifat sigurisht bien në kurriz të konsumatorëve.

**PAGESA**

"News 24" ka arritur të mësojë se Bashkia e Tiranës është njoftuar dhe e ka pranuar propozimin e koncesionarit për të caktuar atë tarifë. Të gjitha këto fakte ngrenë dyshimet për një aferë në favor të vetë koncesionarit. Në bazë të kontratës së nënshkruar me Ministrinë e Mjedisit, kompania, e cila do të ndërtojë edhe inceneratorin, do të paguhet nga Bashkia e Tiranës me një shumë prej 29 eurosh për çdo ton mbetje organike që depozitohet në landfill, nga mjetet që merren me pastrimin e kryeqytetit.



**SHTESAT**

Tani përpos kësaj shume, individë, apo kompani të ndryshme, të cilat e paguajnë një herë taksën e pastrimit do të duhet të paguajnë një tarifë prej 480 lekësh për çdo ton mbetje të dërguar në Sharrë.

Dhe nuk mbaron me kaq. Bashkia e Tiranës me anë të Policisë Bashkiake dhe Inspektoratit Mjedisor nuk i lejojnë kompanitë që të mund t'i depozitojnë mbetjet ndërtimore apo dherat në vende të tjera me një çmim më të ulët.

> Kompanitë duhet të paguajnë një shumë prej 480 lekësh për ton, apo rreth 100 euro për kamion.

PËRKUJTIMI

# Rrëfimet e të mbijetuarve projektohen te ish-shtatorja e Hoxhës

Njeriu arriti te? ndërtojë? shume? mure ndarëse, por edhe arriti t'i shembë? ato, pe?r ke?te? "muri" u kthye ne? element simbolik, i cili simbolizonte mbylljen hermetike te? shoqërisë?, duke kuptuar qe? ishte pikërisht vete? Ai qe? e ndërtonte ate?…Te? gjithe? ne jemi ne? zhvillim te? vazhdueshëm dhe pa ndërprerë? fizik, mendor, shpirtëror dhe politik…Te? gjithe? ne e dime? tashme? qe? muret nuk jane? gje? tjete?r vec? simbolizmi i nje? kubi te? mbyllur anti human, anti komunikim".

Në përkujtim të rrëzimit të shtatores së diktatorit, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit dhe Bashkia e Tiranës, projektojnë instalacionin "Edhe muret kanë veshë", i bazuar mbi dëshmitë e të mbijetuarve të krimeve komuniste. Projektimi bëhet të mërkurën me 20 shkurt në orën 18:00 në vendin ku ka qenë shtatorja e diktatorit.

"Edhe muret kanë veshë" është një angazhim publik i ardhur në formën e një projekti artistik, nga artistja Alketa Xhafa Mripa, e cila qëndron mbas projektit "Mendoj për Ty" - përkujtimore, e cila e bëri kombin e Kosovës të dhurojë dhe të ndejë 5,000 fustane dhe funde në një stadium futbolli në nder të viktimave të abuzimit seksual përgjatë luftës së vendit në 1998-1999.

Me "Edhe muret kanë veshë" Xhafa-Mripa po tenton te? futet thelle? ne?n lëkurën e de?mtuar nga dhimbja dhe mohimi i elementit thelbësor te? ekzistencës njerëzore: LIRISE INDIVIDUALE dhe Lirisë? se? mendimit te? hapur! Artistja tenton te? jete ure?-element në histori, duke marre? shtyse? nga përgjegjësia e forcës se? aktit publik duke mos konsideruar artin bashkëkohor si medium "te? ngushte?" te? ekspozuar ne?pe?r hapësira konvecionale si: muze, galeri etj.. Por ajo e propozon hapësirën urbane si kolektor bashkëveprues me vepra instalative-performative, duke i dhe?ne? nje? sens gjigantesk sensibilizimit kolektiv ndërkombëtar. Vepra e saj e?shte? nje? open-space-memory, ku kufiri i publikut me artin konceptual nuk ka asnjë? problem konfliktual, pe?rkundrazi e be?n vepre?n e saj akoma me? shume? te? drejtpe?rdrejte? dhe pe?rfshire?se, pikërisht kjo e shton me shumë intensitetin e pyetjes: a mund arti te? ndikoje? mbi politikat e gabuara? Artistja ka udhe?tuar pe?rmes Shqipe?rise? (pe?rgjate? periudhe?s 19 - 28 shkurt 2018), dhe ka dokumentuar shume? dëshmi nga personalitete te? artit, intelektuale? apo njerëz te? thjeshte, te? cile?t kane? pe?rjetuar drame?n e tyre personale ne?pe?r burgjet çnjerëzore te? regjimit komunist.







*Përvjetori i "rrëzimit" të diktatorit, në një mënyrë tjetër*

Rrëfimet janë hedhur në një uebsite dygjuhësh, anglisht-shqip për Shqipërinë dhe shqiptarët. Aty dokumentohen histori gojore - duke sjellur rrëfime personale prej atyre që kanë kaluar vështirësi të paimagjinueshme, nga ata që kanë mbijetuar deri më sot për të ndarë dhimbje e histori me të tjerët dhe gjeneratat e reja.

**'EDHE MURET KANË VESHË'**

EDHE MURET KANË VESHË është platforma e rrëfimeve të mbledhura nga AIDSSH. Me historitë e mbledhura me kujdes dhe përgjegjësi, përmes zërave të padëgjuar, AIDSSH i jep një shans më shumë mbështetjes së kërkimit shkencor dhe edukimit qytetar, krahas qasjes së papenguar në dokumentet e Sigurimit të Shtetit në diktaturë.

Metodologjia e EDHE MURET KANË VESHË u zhvillua në kuadër të projektit "Përkujtojmë për të Shëruar dhe Parandaluar", i zbatuar nga AIDSSH, me mbështetjen e UNDP Shqipëri dhe qeverisë së Italisë. Formati i pyetjeve u zhvillua me këshillën e studiuesve nga Instituti i Historisë dhe AIDSSH. Transkriptimi u bë në zyrat e AIDSSH, ku dhe ruhen rrëfimet e regjistruara me zë dhe figurë. Në dukje e thjeshtë, kjo është punë shumë voluminoze dhe e kujdesshme, dhe AIDSSH falënderon të gjithë kontribuesit, por sidomos të mbijetuarit që, ndonëse në pjesën më të madhe kanë moshë të thyer, na i besuan me durim kujtimet e tyre të dhimbshme.

Këto dëshmi do të administrohen me kujdes dhe do t'i vihen në dispozicion çdo studiuesi, në çdo kohë, sipas rregullave të arkivave në Republikën e Shqipërisë dhe vullnetit të qytetarëve që na kanë besuar rrëfimet, përmes marrëveshjes që kanë nënshkruar me intervistuesin. AIDSSH merr përsipër të administrojë dhe ruajë këto regjistrime, me standardin e një arkivi të vyer historik.

Historitë e rrëfyera në këtë platformë hapin faqe të historive personale që premtojnë dhimbje, lot e vuajtje. Por dialogu shoqëror që synojmë të edukojmë e zhvillojmë për të shkuarën mund të realizohet vetëm nëpërmjet kësaj hapjeje e dokumentimi. Sepse është përballja me të vërtetën ajo që e çon shoqërinë drejt shërimit dhe rivendos ekuilibra. Kjo përballje nënkupton edhe zbardhjen e fateve të të pafajshmëve dhe nderimin i sakrificës së atyre që ia dolën me dinjitet njerëzor, duke njohur përjetimet e tyre, përmes zërave të tyre. Ky është hapi i rëndësishëm që hedhim sot.

Kujtesa historike është në themel të identitetit dhe trashëgimisë së individëve e bashkësive. Ajo luan rol në ndërtimin e raporteve mes grupeve të ndryshme të shoqërisë. Mungesa e saj mund të jetë edhe burim i tensioneve apo konflikteve. Iniciativa të tilla të përkujtimit, dokumentimit historik e më gjerë, të gjitha bashkë luajnë rol në krijimin dhe zhvillimin e një pikëpamjeje historike të individëve e grupeve të caktuara dhe janë mjete komunikimi të diskutimit lokal apo kombëtar a më gjerë.

"Tregimi im, është detyrim moral për prindërit e mi, për veten time, për ju o bij, për bashkëvuajtësit e mi dhe për shoqërinë",-shprehej një nga të mbijetuarit që dëshmoi kalvarin e vet gjatë diktaturës. Pikërisht ky është motivi që na shtyn përpara në punën tonë.

Gentiana Sula është kryetare e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe nismëtare e projektit të dëshmive gojore dhe krijimit të arkivit e platformës përkatëse pranë AIDSSH.

## SHPREHJET E TË MBIJETURAVE

- Një popull pa kujtesë nuk është popull me dinjitet.
- Duhet thye heshtja! Kjo heshtje e thellë më tmerron.
- Nëpër burgje e kampe ishin ndër fisnikët e rrallë të kombit shqiptar...
- Ne trajtoheshim sikur nuk ishim pjesë e kombit, lum kush na godiste më shumë, mjerë kush na përkrahte!
- Sigurimi i Shtetit qëndronte mbi gjithçka. Ai bënte edhe shiun, edhe diellin në Shqipëri.
- Njerëzit duhej të jetonin me ankthin e një pasigurie të plotë.
- "Fajet" tona ishin prodhime të fantazisë së tyre të sëmurë.
- Shpifja, në praktikën e punës së hetuesisë, quhej "art profesional".
- Si arsimtarë, pamë lakuriq gënjeshtrën e madhe që mbillej e kultivohej me kujdes.
- Që në moshën gjashtëvjeçare u njoha me qelinë apo birucën
- Jeta për ne ishte "mollë e ndaluar".
- Ne rriteshim duke u bindur se "revolucioni" kërkonte viktima dhe ne ishim kurbanët e kapur për të.
- Në atë kohë, ishte zgjuarsi e prakticitet t'i fshihje aftësitë e tua.
- Kur të flasësh, mbulo kokën me jorgan, që mos të të dëgjojë njeri!
- Që kur arrestoheshim, derisa liroheshim ose vdisnim, ishim vetëm një numër.
- Ai që kishte mbjellë vëllavrasjen na predikonte dashurinë, si "baba i kombit".
- Ne ishim fatkeqë, stoikë dhe ëndërrimtarë të palodhur.
- Hyra në jetë gati i plakur, pa familje dhe pa shpresë për të krijuar një të tillë.
- Mosdenoncimi i krimit nga fajtorët dhe ndjesa e munguar është "tragjedia e dytë shqiptare".
- Ne s'e humbëm besimin tek e mira dhe shpëtuam kryesoren, duke mbetur njerëz.

AKTORJA





# Një kërcim për paqen ARTA DOBROSHI

Nga Luan Rama

Ti na bëre të kërcenim të gjithë! - i them aktores Arta Dobroshi.

Ajo qesh.

- Atëherë do doja ta fotografoja për mua kërcimin tuaj, - vazhdoj unë.

- Me gjithë qejf, - përgjigjet ajo dhe u tërhoq në sfondin e bukur të asaj salle në "Hôtel Raphael", ku ishim mbledhur për të festuar festën e Kosovës.

Ambasadori i Kosovës, Qëndrim Gashi na foli për surprizën e tij në këtë ceremoni, për praninë aty të aktores së famshme Arta Dobroshi, këtë Ambasadore të Paqes, e cila përreth asaj salle kishte vendosur fotografi të rinjsh anonimë që bënin një kërcim për Paqen. Thjeshtë një kërcim. Një kërcim i bukur. Do donim të kërcenim kështu për Paqen gjithë jetën.

- Atëherë ti do numërosh deri në tre dhe unë do hidhem! - më thotë ajo ëmbëlsisht.

Dhe kështu tërhiqet pranë flamurit të Kosovës.

- Një, dy, tre! - dhe unë fotografoj atë kërcim ajror.

Është i bukur ky kërcim, kjo zgjatje e trupit në kërkim të diçkaje sublime, ajrore, nuk është divine, por shumë tokësore, pasi Paqja është thirrje, klithmë, nanuritje, ç'të duash, veçse dëshirë për një botë më të mirë dhe pa luftë. Nga vjen kjo thirrje?- mendon dikush… Dhe përgjigja është vetë në emrin e saj. Ajo vjen nga Kosova. Vjen nga lufta dhe mizoria. Vjen nga klithma e madhe e lirisë dhe e paqes.

Po, është magjike ta shohësh këtë kërcim paqeje këtu, dy hapa nga Sheshi i Harkut të Triumfit, dy hapa nga ajo sallë ku u firmos dokumenti i Rambujesë. Ja pse fluturimi i saj kishte shumë hire, përtej hireve të trupit dhe zemrës së një vajze, të një gruaje.

Eja të kërcejmë sërish e dashur! A mund ta prekim paqen?

Motra religjioze Edith, në dejet e së cilës ka shumë dashuri e përkushtim shqiptar, ka një ngazëllim të madh. Ato shkëlqejnë nën rrezet e atij dielli të bukur që depërtojnë aty, nga cepi i Harkut të Triumfit. Ngazëllehen pasi shumë vite më parë, kur Arta ishte një vogëlushe, ajo e kishte parë në oborrin e gjyshes së saj, atje në Kosovë. Sa pikëtakim i bukur ta gjejë sërish këtu dhe për më tepër me një kërcim të tillë. Do të donte padyshim që ky kërcim të mos mbaronte kurrë.



## *Aktorja kosovare në Paris dhe një bisedë pranë Harkut të Triumfit*

Eja të vallëzojmë e dashur, me atë trup të bukur sikur të kërcejë vetë Kosova. Shoh Artën dhe ndjej dehjen e saj. Ja çdo të thotë të dehesh pas shumë mizorish, vdekjesh, humbjesh. Nuk ishte diçka nga përrallat. Ishte një e vërtetë klithëse.

Eja të kërcejmë e dashur, Kosovë e dashur, në këtë dans të Paqes. Të gjithë do të na ndiqnin nga pas.

Arta Dobroshi vazhdon kërcimin e saj përmes artit, forcës së saj aktoriale në shumë nga skenat e botës. Ka një energji të jashtëzakonshme në vështrimin e saj, në atë gjoks të hapur si një Marianë franceze të kohës së Revolucionit dhe të kohërave moderne. Ti je një Marianë e dashur, mërmëris nën zë, një Marianë e Kosovës.

E imagjinoj atë zemër, e ndjej atë puls. Ç'gëzim për një vajze si ajo. Ç'gëzim për një Kosovë që feston Pavarësinë e saj në tokën e Francës, ç'gëzim kur një natë më parë flamuri i Kosovës ishte shpalosur atje në Harkun e Triumfit, pranë flakës së varrit të Ushtarit të Panjohur. Martirët pikëtakohen gjithnjë. Arta Dobroshi nuk e kishte imagjinuar që flamuri i vendit të saj do të shpalosej atje ku ishte ngritur flamuri për Hygonë, ai flamur që kishte mbuluar arkivolin e tij për ta shoqëruar gjer në portat e Panteonit. Nuk e kishte imagjinuar aty nën dritën e flakëve që shndrisnin, në atë flakë të përhershme që na kujton gjithnjë martirët e Francës, të Kosovës, të mbarë botës.

Eja të kërcejmë sërish e dashur. Dua që ku dans të mos reshtë kurrë!...

## PËRKUJTOHET LUIGJ GURAKUQI

Muzeu Historik Kombëtar ka përkujtuar dje datëlindjen e Luigj Gurakuqit gjatë takimit "Një pasdite në muze". Tema ishte "Luigj Gurakuqi-Bashkudhëtar i shtetit shqiptar". Këto takime periodike bëhen me qëllimin për të sensibilizuar shoqërinë shqiptare mbi çështje të ndryshme të historisë, kulturës dhe trashëgimisë kombëtare shqiptare. Gjithashtu, veprimtaria "Një pasdite në muze" ka për qëllim ngjizjen e një debati profesional në disiplina të ndryshme. Për të referuar për këtë temë qenë e të pranishëm Prof. As. Dr. Tomi Treska dhe Z. Ledio Xhoxhi, Përgjegjës i Menaxhimit të Koleksioneve në Muzeun Historik Kombëtar. Luigj Gurakuqi luftoi jo vetëm për një Shqipëri të lirë e të pavarur, por edhe për një shtet modern, i cili nëpërmjet reformash demokratike do të zhdukte prapambetjen, do të ndryshonte me shpejtësi pamjen e tij, do të fitonte kohën e humbur gjatë shekujve të robërisë.

Muzeu Historik Kombëtar i organizon këto takim shkencor-social me një natyrë periodike, për të përkujtuar figura të shquara të historisë dhe të letërsisë shqiptare, ballkanike dhe europiane që kanë shkruar dhe kanë kontribuar për evidentimin e vlerave kulturore. Në këtë veprimtari do jenë të pranishëm dhe të ftuar, akademikë, studiues e miq, studentë dhe dashamirës të fushave të ndryshme.

Gurakuqi lindi më 19 shkurt 1879 dhe u vra më 2 mars 1925 në Bari të Italisë. Luigj Gurakuqi kreu Kolegjin e Shën Adrianit në fshatin arbëresh të Shën Mitrit në Itali dhe studioi për mjekësi e biologji në Universitetin e Napolit. Ai ka një veprimtari të pasur letrare, publicistike, kombëtare dhe politike. Veprimtaria e tij filloi me poezi lirike dhe përkthime në gjuhën shqipe. Vijoi me botimin e teksteve të abetares në dy dialektet e shqipes. Shkroi artikuj në organet e shtypit shqiptar. Në vitin 1908 mori pjesë si nënkryetar i komisionit për njësimin e alfabetit në Kongresin e Manastirit. Është hartuesi i parë i veprës "Metrika Shqip". Më 1911 ishte një prej hartuesve të Memorandumit të Greçes gjatë kryengritjes së malësorëve të Mbishkodrës të vitit 1911. Në vitin 1912 mori pjesë në mbledhjen e Bukureshtit. Ishte në Kuvendin e Vlorës për Shpalljen e Pavarësisë dhe u caktua Ministër i Arsimit nga Ismail Qemali. Në vitin 1916 u caktua Drejtor i Përgjithshëm i Arsimit dhe anëtar i Komisisë Letrare në Shkodër. Në vitin 1918 mori pjesë në Kongresin e Durrësit dhe u zgjodh Ministër i Arsimit dhe anëtar i delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris. Në vitet 1921-1924 ishte deputet në Këshillin Kombëtar. Gurakuqi u përfshi në Lëvizjen e Qershorit të vitit 1924 dhe u zgjodh Ministër i Financave në qeverinë e Fan Nolit



Intervista e Ditës

# Uzurpimi i pavarësisë

Nga Veton Surroi

*(vijon nga faqja 1)*



...e kalon kohën: "Kurrë nuk është vonë me e lanë duhanin... dhe Kosovën". Kështu ka thënë publicisti dhe shkrimtari, Veton Surroi, në intervistën e javës për "Kohën Ditore".

Sipas tij, kjo do të thotë që vendi është shndërruar në emërtues për mungesë perspektive, teksa ka mundur të ndodhë krejt e kundërta - "që Kosova të mos e vendoste pavarësinë e vet në kandar pazari, të investonte në kapitalin njerëzor nëpërmjet arsimit, të krijonte ambientin për një ekonomi kompetitive, në të cilën ndërmarrësia dhe bujqësia do të krijonin zhvillimin e perspektivën". Surroi, që ka qenë njëri prej nënshkruesve të Marrëveshjes së Rambouillet, i ka bërë një përshkrim rrugës deri në pavarësi dhe pas saj. "Ky projekt i menduar mirë, një herë i realizuar me pavarësinë e vendit, u uzurpua. Ashtu si u uzurpuan banesat, tokat, dyqanet, fabrikat, ashtu u uzurpua edhe ky projekt", ka thënë Surroi. Sipas tij, një grup i dhunshëm i njerëzve, që identifikohen tashmë prej kohësh me Hashim Thaçin, e shndërruan projektin e pavarësisë në projekt të grabitjes, të kapjes së shtetit, të pasurimit të tyre klanor, grupor e individual. Sa i përket dialogut, Surroi ka thënë se, shtetësia e Kosovës u vu në tavolinë ditën kur Hashim Thaçi pranoi që të negociojë me Serbinë si kryeministër i shtetit, pavarësia e të cilit është e diskutueshme.

Sipas Surroit, Kosova duhet të kthehet te platforma bazike, ajo me të cilën kërkon negociata të barazisë me Serbinë, pra negociata për fqinjësi të mirë, jo për vazhdimësi të pranisë së Serbisë në Kosovë.

## SHTETI, I SHNDËRRUAR NË AFORIZËM

**KD: Sot shënojmë 11 vjet nga shpallja e Pavarësisë së Kosovës. Çfarë ka mundur të arrijë Kosova për 11 vjet shtet?**

Surroi: Kosova sot është një shtet, i cili ka vënë në pikëpyetje shpalljen e pavarësisë, tërësinë e vet tokësore dhe rregullimin kushtetues. Për më tepër, është shndërruar në shtet ku shumica e popullatës (gati 80 për qind e nxënësve nën moshën 15-vjeçare) janë analfabetë funksionalë. Kjo shumicë e popullatës nuk ka perspektivë ekonomike, për shkak se investimet e parasë publike kanë shkuar për asfalt, korrupsion të përmasave industriale, punësim në sektorin publik të njerëzve të afërt me partinë apo klanin regjional dhe në shpenzime të kësaj kategorie që e ka të kapur shtetin.

Për shumicën e madhe të qytetarëve, ky shtet është shndërruar në një aforizëm për media sociale, aty ku shumica e popullatës së vendit e kalon kohën: "Kurrë nuk është vonë me e lanë duhanin... dhe Kosovën". Kjo do të thotë që vendi është shndërruar në emërtues për mungesë perspektive.

E ka mundur të ndodhë krejt e kundërta. Pra, që Kosova të mos e vendoste pavarësinë e vet në kandar pazari, të investonte në kapitalin njerëzor nëpërmjet arsimit, të krijonte ambientin për një ekonomi kompetitive, në të cilën ndërmarrësia dhe bujqësia do të krijonin zhvillimin e perspektivën. Në vend se të shkonin në asfalt, dy miliardë euro kanë mundur ta zgjidhnin prodhimin e energjisë elektrike, ndotjes së ambientit në Rrafshin e Kosovës dhe të hapnin vende të reja pune në sektorë strategjikë të ndërmarrësisë e bujqësisë.

**KD: Gjatë viteve ka pasur shumë kritika ndaj vendimmarrjes dhe shtetndërtimit në Kosovë. Edhe ju vetë keni qenë mjaft kritik ndaj udhëheqësve të Kosovës. Cilat janë pikat kryesore të kritikës suaj? Çka saktësisht ka shkuar keq?**

Surroi: Rruga deri në pavarësi ka qenë një projekt i menduar. E kemi filluar në vitin 1989 si alternativë, në procesin e zhbërjes së ish-Jugosllavisë, që pasoi rënien e Murit të Berlinit. Ajo alternativë, që më vonë do të identifikohej në masë të madhe me figurën e dr. Rugovës kishte konceptuar një rrugë që nëpërmjet të një lëvizjeje popullore, paqësore e konsensuale të rreshtohej drejt Perëndimit dhe në bazë të evolucionit kushtetues-juridik që kishte pasur Kosova në RSFJ, me kulminacion atë të vitit 1974, të mbërrinte përmbylljen e vetme logjike, pavarësinë e vendit. Ky proces arriti të zhvillohej në fund edhe me nevojën për luftë të armatosur, që çoi drejt shpejtimit të përmbylljes, me angazhimin e bashkësisë ndërkombëtare për një protektorat.

Ky projekt i menduar mirë, një herë i realizuar me pavarësinë e vendit, u uzurpua. Ashtu si u uzurpuan banesat, tokat, dyqanet, fabrikat, ashtu u uzurpua edhe ky projekt. Një grup i dhunshëm i njerëzve, që identifikohen tashmë prej kohësh me Hashim Thaçin, e shndërruan projektin e pavarësisë në projekt të grabitjes, të kapjes së shtetit, të pasurimit të tyre klanor, grupor e individual.

Ata e shfrytëzuan pavarësinë e vendit prej Serbisë për ta pushtuar nga grupi i tyre.

Serbia është dashur të përdorë zhbërjen e autonomisë e Kushtetutës, përdorimin e forcave okupuese policore e ushtarake dhe angazhim të serbëve lokalë, si administratorë kolonialë për ta mbajtur Kosovën të okupuar.

Grupi i kapësve të shtetit përdorën zbrazëtinë juridike të krijuar në protektorat të UNMIK-ut për të vendosur, me dhunë e vjedhje votash, një rrjet të organizuar për kapje të shtetit. Sot nuk ekziston asnjë institucion publik - gjykatë, polici, RTK, PTK e çfarëdo tjetër - ku nuk ka përfshirje në vendimmarrje nga grupi i dhunshëm i identifikuar me Hashim Thaçin.

Ky grup, që për kaq shumë vjet është marrë me kapjen e shtetit dhe shkatërrimit të çdo gjëje që është pjesë e hapësirës publike - duke bërë për vete të mirat e kësaj hapësire - e ka bërë këtë si koncept të menduar. Pra, ditën kur e trashëguan projektin e Pavarësisë, si një projekt të menduar nga viti 1989, filluan me projektin e tyre të menduar, si ta pushtojnë këtë shtet për nevoja të tyre.

**KD: Tani jemi në atë që po quhet faza e fundit e dialogut me Serbinë, e cila pritet që shumë shpejt të prodhojë një marrëveshje "normalizimi", por që në një mënyrë apo tjetër mund të jetë edhe rihapje e Pavarësisë së Kosovës. Mendoni se në tavolinën e bisedimeve të Brukselit është vënë edhe shtetësia e Kosovës?**

Surroi: Shtetësia e Kosovës u vu në tavolinë ditën kur Hashim Thaçi pranoi që të negociojë me Serbinë si kryeministër i shtetit, pavarësia e të cilit është e diskutueshme. Ai pranoi të hyjë në negociata të lehtësuara nga BE-ja pasi që Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, në korrik të vitit 2010 dha mendimin se shpallja e Pavarësisë së Kosovës nuk ishte në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare. Hashim Thaçi dhe Serbia u ulën për të biseduar për Kosovën, duke u pajtuar paraprakisht se Serbia ka të drejtë t'i kontestojë pavarësinë dhe shtetësinë e Kosovës.

Rrjedhimisht, Hashim Thaçi ia njohu të drejtën Serbisë që bashkërisht të ndërhyjnë në sistemin kushtetues-juridik të vendit, duke u pajtuar që Kosova të themelojë autonominë territoriale politike serbe (bashkësinë e komunave serbe) dhe të vendosë instrumente segregacioni etnik në polici e gjyqësi në pjesën veriore të vendit, mbi lumin Ibër.

## KOSOVA TË KTHEHET TE PLATFORMA BAZIKE.

**KD: Dialogu me Serbinë nuk ka dhënë rezultatet e premtuara. Nuk është arritur pajtimi me Serbinë, integrimi i serbëve nuk ka ndodhur plotësisht si dhe nuk është zbardhur fati i të pagjeturve. Çfarë transformimi duhet bërë dhe cili do të duhej të jetë interesi i Kosovës nga ky dialog?**

Surroi: Historia e shkurtër e "dialogut" me Serbinë është kjo. Pas vitit 1945, kur Serbia (dhe udhëheqja jugosllave) mohuan të drejtën e Kosovës të bashkimit me Shqipërinë, ashtu siç kishte proklamuar Rezoluta e Bujanit, nënshkruar nga forca fitimtare e Luftës së Dytë Botërore, Kosova u aneksua nga Serbia dhe filloi një proces evolutiv largimi nga Serbia në pikën më të ulët të mundshme, okupimi. Që nga viti 1945 deri në vitin 2007, forca të ndryshme politike të Kosovës, në shumicë dërrmuese, shqiptarë, zhvilluan një proces të largimit të pushtetit të Serbisë nga Kosova. Në kuadër të Jugosllavisë socialiste, prijësit shqiptarë arritën formën më të lartë të mëvetësisë me Kushtetutën e vitit 1974, ndërsa gjenerata e Alternativës (pjesë e së cilës isha) e çoi në çlirim dhe Republikë të Kosovës, shtet i pavarur i njohur nga mbi 100 shtete.

Procesi historik i largimit të Serbisë 1945-2008 u zëvendësua me projektin e negociatave për kthimin kushtetues të Serbisë në Kosovë. Në këtë projekt, përfaqësues eminent i Kosovës është Hashim Thaçi.

Transformimi konceptual është bukur thjesht i shpjegueshëm në këtë rrëfim të shkurtër: Kosova duhet të kthehet te platforma bazike, ajo me të cilën kërkon negociata të barazisë me Serbinë, pra negociata për fqinjësi të mirë, jo për vazhdimësi të pranisë së Serbisë në Kosovë.

**KD: Në kuadër të projektit të KFOS-it për mbështetje dialogut, keni zhvilluar disa takime me udhëheqës shtetërorë dhe përfaqësues të opozitës. Cila është ndihma që synoni të ofroni dhe a do të jeni pjesë e ekipit negociator?**

Surroi: Projekti ka parasysh identifikimin e pikave të mundshme konsensuale në spektrin politik të Kosovës, dhe më gjerë, në shoqëri civile. Të gjithë liderëve u kemi ofruar atë që kemi identifikuar, në bazë të debatit që kanë zhvilluar vetë përfaqësuesit e partive dhe të shoqërisë civile, pikat që mendojmë se reflektojnë konsensusin e tyre.

Që të gjithë liderët, të përfshirë a jo në procesin negociator, kanë mirëpritur draftet e prezantuara.

**KD: Për ta përmbyllur kapitullin me Serbinë, një institucion kushtetues, siç është presidenti nuk e përjashton as opsionin e ndryshimit të kufijve. Apo rrezikohet Kosova e 17 shkurtit nga këto përpjekje dhe çfarë vepritmesh do të ndërmerren për ta parandaluar këtë?**

Surroi: Hashim Thaçi me përsëritjen se është gati të bëjë këtë apo atë ndryshim në Kushtetutë të Kosovës bën, me vetëdije apo jo, dy gabime. Një, tregon sjelljen e kapësit të shtetit, pra të atij që duke qenë padron i Kushtetutës, territorit, PTK-së, RTK-së, ish-Kooperativës së Malizhganit etj., mund të hedhë në pazar kur të dojë. Dy, duke i vënë në pazar, tregon se çdo gjë është për pazar, sepse nëse mund të vihet për negociata territori dhe rregullimi kushtetues i vendit, atëherë e tërë paketa e konsolidur e pavarësisë, e vulosur me mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të drejtësisë më 2010 është, po ashtu, për debat.

**KD: Kosova është futur në telashe me Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimin Evropian, për shkak të refuzimit të kryeministrit që ta pezullojë taksën ndaj mallrave serbe, për t'i dhënë shans marrëveshjes përfundimtare me Serbinë. A prodhon pasoja, mbajtja në fuqi e kësaj mase?**

Surroi: Pa dyshim që prodhon pasoja, për që të gjithë. Një masë prej 100 për qind për produktet serbe tregon nivelin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë. Është krejtësisht e qartë se kjo masë duhet të hiqet, por është krejtësisht e paqartë kur dhe si.

Caku duhet të jetë një gjendje normaliteti mes Kosovës dhe Serbisë, në një hapësirë të lëvizjes së lirë të mallrave, kapitalit dhe njerëzve dhe drejt këtij caku duhet punuar. Por, nuk jam i sigurt që drejt këtij caku është negociuar në Bruksel, përkundrazi. Dhe kjo gjë sjell paradoksin e radhës: po të hiqet taksa sot, në interes të një caku për lëvizje të lirë të mallrave e njerëzve mund të rikthehemi te një proces negociator të kotë e të dëmshëm, të cilin e ka zhvilluar me "suksesin" e parë deri tani Hashim →

Dje në "Deutsche Welle"

# Opozita, pse i djeg mandatet dhe kërkon zgjedhje të parakohshme

Nga Ani Ruci

*(vijon nga faqja 1)*



... pas vendimit të saj për të djegur mandatet parlamentare, të propozuar nga lideri i Partisë Demokratike (PD), Lulzim Basha dhe mbështetur nga partitë e tjera opozitare. Ajo publikohet pas protestës masive të 16 shkurtit, kur opozita nuk ia doli mbanë të largojë kryeministrin Rama dhe të rrëzojë qeverinë e tij. Lideri i PD, Lulzim Basha, e cilësoi parlamentin aktual si "të dalë me votat e krimit dhe mafies në zgjedhjet e manipuluara të 25 qershorit 2017" dhe vendimin e dorëzimit të mandateve parlamentare të opozitës në këtë parlament në funksion "të zgjidhjes politike të ofruar nga opozita për një qeveri tranzitore, të gatshme për të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme, që do të garantojnë zgjedhje të lira dhe të ndershme dhe zhbllokimin e procesit të integrimit europian të Shqipërisë, hapjes së negociatave me Bashkimin Europian, përmes zgjedhjeve të lira dhe të ndershme të parakohshme parlamentare".

Komisioni Europian: Djegia e mandateve, kundërproduktive

Zëdhënësja e Përfaqësueses së Lartë të BE për Politikë të Jashtme, Maja Kocijançiç, e cilësoi heqjen dorë nga mandati i deputetit nga ana e PD dhe partive të tjera opozitare si "kundërproduktive dhe që shkon kundër përpjekjeve të Shqipërisë për zbatimin e reformave të kërkuara nga BE". Parlamenti është baza e çdo demokracie europiane, është vendi ku debatet për reformat dhe zhvillimet përkatëse duhet të diskutohen dhe jo të bojkotohen. Presim që qeveria dhe opozita të angazhohen në diskutime konstruktive, me qëllim tejkalimin e situatës aktuale politike", theksoi Maja Kocijançiç të hënën, në një deklaratë për Agjencinë Telegrafike Shqiptare.

A është vendimi i opozitës "një ?adër në formë bojkoti"?

Por, situata politike është shumë e rënduar për të realizuar shpejt pritshmëritë e Komisionit Evropian për dialog qeveri-opozitë. Vendimi i opozitës është i paprecedentë në historinë e demokracisë post-komuniste në Shqipëri dhe që flet sesa e pakonsoliduar shfaqet ajo. Mazhoranca u shfaq të hënën e pashqetësuar nga vendimi i opozitës për të dorëzuar mandatet aktuale parlamentare. Kryeministri Rama në mbledhjen e grupit parlamentar të PS kërkoi "fokusimin në përgatitjen e zgjedhjeve lokale" të parashikuara për t'u zhvilluar pas 4 muajsh, në qershor. Ai e cilësoi vendimin e opozitës "blof, një çadër në forme bojkoti para zgjedhjeve të qershorit", duke risjellë në kujtesë precedentin e opozitës në zgjedhjet parlamentare të qershorit 2017, kur pas protestës 3-mujore të opozitës në ?adrën e ngritur përballë Kryeministrisë, për të kërkuar garantimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, PD u fut në zgjedhje në minutën e fundit, pas marrëveshjes 'Rama-Basha' dhe marrjes së posteve qeveritare në qeverinë e drejtuar po nga Rama, si një formulë e dakordësuar e kontributit të opozitës për të garantuar që zgjedhjet parlamentare të qershorit 2017 të ishin të lira dhe të ndershme. Analistët e pavarur në Tiranë, nisur nga precedenti i marrëveshjes 'Rama-Basha', që futi PD në zgjedhjet e 2017-ës, ngrenë pikëpyetje nëse pas vendimit të heqjes dorë nga mandatet parlamentare fshihet përsëri një "pazar".

Cilët janë skenarët e mundshëm pas vendimit të opozitës?

Të dorëzosh mandatin e deputetit nuk është e thjeshtë nga pikëpamja procedurale. Burime zyrtare nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) thanë për 'DW' se kjo bëhet në këtë komision, në mënyrë individuale dhe jo "en block" në bazë të Kodit Zgjedhor. Pas procedurës së dorëzimit të mandatit, KQZ-ja shikon zëvendësimin e deputetëve që lanë mandatin me kandidatët që nuk fituan në zgjedhjet parlamentare të qershorit 2017. Lista e PD rezulton të jetë me 194 kandidatë, nga të cilët fituan vetëm 43, që do të thotë se ka 151 kandidatë që mund të zëvendësojnë 43 të ikurit potencialë. Kodi Zgjedhor parashikon që nëse asnjë prej tyre nuk pranon mandatin duke iu bindur vendimit të PD, atëherë 43 deputetët opozitarë zëvendësohen me kandidatë nga lista e PS. Por, ky skenar nxjerr problem cilësinë e qeverisjes, që ulet ndjeshëm në një parlament, ku opozita ose nuk përfaqësohet, ose përfaqësohet fare dobët.

---

Thaçi.

Më duket që do të ishte mirë të punohet paralelisht për pezullimin e taksës dhe fuqizimin e kornizës negociatore mes Kosovës dhe Serbisë.

**MODEL I SHANTAZHUESHMËRISË**

**KD: Sa ka nevojë të ndryshohet marrëdhënia që Kosova ka ndërtuar me ndërkombëtarët gjatë këtyre viteve?**

Surroi: Diplomatët janë njerëz si të gjithë të tjerët. Nëse shohin se pala tjetër është e dobët apo e shantazhueshme atëherë këtë do ta shfrytëzojnë.

Marrëdhëniet e bashkësisë ndërkombëtare me liderët kosovarë gjatë dhjetëvjetëshit të fundit janë ndërtuar në masë të madhe me modelin e shantazhueshmërisë së Hashim Thaçit. Gjatë dhjetë vjetëve raporti Marty ka krijuar jo vetëm Gjykatën Speciale, por edhe tërë sjelljen ndërkombëtare të Kosovës. Shteti ynë paguan për shumë vjet me radhë agjenci lobimi në Uashington e gjetiu jo për të avancuar interesat e vendit, por për të penguar shkuarjen e Hashim Thaçit në burg. Porosia e vetme të cilën e promovojnë lobuesit formulohet me këtë thjeshtësi: Hashim Thaçi nuk është kriminel, është burrështetas dhe partner i besueshëm i Perëndimit.

Nga ky këndvështrim, është lehtë i kuptueshëm modeli i pranimit të çdo gjëje që vjen nga diplomatët në dhjetë vjetët e fundit.

Për ata që kanë pak kujtesë të mbetur, ndoshta mund t'iu bjerë në mend se para disa vitesh ambasadorë të vendeve shumë të respektuara në Kosovë deklaronin se Bashkësia e komunave serbe, e atillë çfarë pranoi Hashim Thaçi, është në interes të Kosovës.

**KD: Në shumë raporte vendore dhe ndërkombëtare Kosova përshkruhet si vend që udhëhiqet nga krimi i organizuar dhe korrupsioni, ku ka mungesë të zhvillimit ekonomik e nivel të lartë të papunësisë? Si duhet ndryshuar kjo gjendje?**

Surroi: Siç thash, modeli Thaçi i kapjes së shtetit është ai që ka krijuar këtë gjendje. Dhe kjo gjendje ndryshon vetëm me ndryshim modeli.

Duhet zgjim, zgjim i të gjithë të zhgënjyerve. E të zhgënjyerit përbëjnë shumicën, ata gjithnjë përbëjnë shumicën.

Kapësit e shtetit, si dikur me Millosheviçin, janë pakicë.

**KD: Matjet e pulsit publik kanë treguar në vazhdimësi për rënien e besimit në politikë, liderë dhe institucione? Nëse vazhdon ky trend i rënies së besimit, cilat do të jenë pasojat në vitet e ardhshme?**

Surroi: Janë tri rrugë të mundshme. Një, shkërmoqja e mëtejme e shtetit dhe shoqërisë, me një model tashmë të verifikuar, të jetës prej mjeteve të diasporës. Dy, e në rrjedhë me rrugën e parë, rritja e numrit të të larguarve nga ky vend, në mënyrë që të financohet vazhdimësia e shkërmoqjes. Dhe tre, ngritja në këmbë e të zhgënjyerve, e atyre që u bie ta çlirojnë sërish vendin.

**KD: Cila është rruga që duhet ndjekur drejt ndërtimit të një konsensusi për të ardhmen e shtetit?**

Surroi: Gjendja më duket si në pjesën e dytë të viteve tetëdhjetë. Mund të ketë mbetur vetëm rruga.

---

## HOROSKOPI

### DASHI

Përshtatja me mënyrat e reja të bërjes së gjërave zakonisht është e lehtë për ju, por sot mund të ndiheni pak të tronditur nga gjërat e shpejta që po zhvillohen dhe ndryshohen. Mos prisni që të bëheni mjeshtër i çdo gjëje brenda natës.

### DEMI

Nëse një kontratë, një marrëveshje ose ndonjë lloj tjetër dokumenti ligjor ju vendoset përpara sot, mos nënshkruani asgjë! Marrëveshja që ju ofrohet sot është mirë, por universi mund të ketë diçka tjetër në pritje për ju.

### BINJAKET

Vetëm për shkak se dikush ka pushtet mbi një aspekt të jetës suaj nuk do të thotë se ai ose ajo ka fuqi mbi tërë jetën tënde! Mos ia jepni kontrollin e jetës tuaj një tjetri. Ju nuk keni nevojë që dikush t'ju tregojë se çfarë të bëni.

### GAFORJA

Nuk është detyra juaj t'u tregoni njerëzve të tjerë se si të jetojnë jetën e tyre, por në këtë rast, mund të kërkohet një këshillë e vogël miqësore e dhënë në një mënyrë jo gjyqësore, mbështetëse, sigurisht.

### LUANI

Një ditë çuditërisht e rehatshme do t'ju japë kohë për t'u bashkuar me miqtë tuaj për biseda rreth shpresave tuaja, dëshirave tuaja dhe, si zakonisht, të gjitha thashethemet e fundit. Do të habiteni kur të kuptoni se nuk dini asgjë për një situatë disi të çuditshme në rrethin tuaj shoqëror!

### VIRGJERESHA

Është emocioni, jo logjika e ftohtë, që do t'ju ndihmojë të zgjidhni një mister mbi të cilin po mendoni shumë. Ju mund të kaloni gjithë kohën tuaj mbi detajet e vogla dhe të kërkoni për një element që mungon, por kjo do të ishte humbje kohe.

### PESHORJA

Një lajm shumë i mirë po ju vjen sot, dhe këtë duhet ta ndani me një person tjetër! Nuk ka rëndësi nëse ky person e kupton plotësisht madhësinë e lehtësimit apo lumturisë tuaj, ajo që ka rëndësi është se ky person e di se si të argëtoheni.

### AKREPI

Do të ketë një tundim të fortë për të dalë jashtë rutinës tuaj sot, por ky nuk mund të jetë një veprim i zgjuar. Ka shumë pasiguri për momentin dhe mund të jetë më e sigurt që t'i përmbahemi planit të lojës pa marrë parasysh sa e mërzitshme apo e vështirë mund të jetë.

### SHIGJETARI

Disa njerëz simpatik do të hyjnë në jetën tuaj duke ju mbajtur të zënë me të gjitha bisedat e tyre të ëmbla dhe ngjarjet emocionuese shoqërore. Kjo është një ditë shumë argëtuese, aktive për ju dhe plot me ide të reja.

### BRICJAPI

Sot do t'ju mungojë durimi me një mik. Jepini mikut tuaj një thirrje zgjimi sot dhe kujtojeni atë për historinë tuaj - dhe për disa detyrime të rëndësishme. Kjo bisedë do t'ju prezantojë me një ose dy fakte të reja që mund të shpjegojnë sjelljen e kohëve të fundit.

### UJORI

Kush thotë se anët e kundërta tërheqin? Jeta juaj e dashurisë po vazhdon në një fazë disi aktive dhe sot do të përjetoni një lidhje të fortë intelektuale me dikë që është shumë i ndryshe nga ju.

### PESHQIT

Keni nevojë për një udhëtim diku? Kjo është mundësi e përkryer për të kërkuar një favor miqësor. Nisja e bisedave do të jetë shumë e lehtë sot, sepse njerëzit për të cilët interesoheni do të jenë kurioz për ju.

**Ndërkohë, Vanda vijon betejën**

## Kriza tek Interi nuk ka fund, Ikardi nuk feston ditëlindjen me ekipin

Klubi e ka uruar, Vanda i ka dedikuar një mesazh plot dashuri dhe Maurito, nga ana e tij ka publikuar një foto të tij me bashkëshorten në liqenin e Komos. Por pavarësisht këtyre postimeve, edhe dje në shtëpinë e Interit nuk ka ardhur qetësia, ndonëse Mauro Ikardi mbush 26 vjeç pasi në "Appiano Gentile" nuk ka shumë për të festuar. Sulmuesi argjentinas ka marrë urimet nga shokët e skuadrës, por në të vërtetë asgjë nuk ka ndryshuar në krahasim me ditët e fundit. Ish-kapiteni ka vijuar të punojë veçmas dhe rikthimi i tij në skuadër është ende larg. Sesa larg, ende nuk dihet, por e sigurt është se ndaj Rapidit të Vjenës ai nuk do të jetë sikundër dhe sfida e radhës në kampionat kundër Fiorentinës. Përshtypja është se beteja e heshtur po vijon dhe se nga ana e Ikardit nuk ka aspak vullnet që të rikthehet në hapat e dikurshëm, të paktën derisa kur t'i rikthehet shiriti i kapitenit. Një tunel, ku tani për tani, nuk duket dritë në fund të tij. Dhe duke qëndruar në këtë klimë surreale, edhe programimi i kontrolleve për gjurin e tij nga ana e doktor Volpit, ngjan si diçka e dyshimtë. Sepse është normale që një i dëmtuar të kontrollohet, por duke qenë se jemi në mes të një psikodrame Inter-Ikardi, edhe ky kontroll normal mjekësor bëhet i dyshimtë. Sot për sot, në shtëpinë e Interit, situata është kjo.



## Akuza e kushëririt të Salas: Emilianon e vranë

Pas dyshimeve të forta nga ana e së fejuarës, të publikuara dhe më pas të fshira nga rrjetet sociale, tashmë është kushëriri i Emiliano Sala që hedh hije dyshimi mbi vdekjen e sulmuesit 29-vjeçar, avioni i të cilit u rrëzua në kanalin e La Manshit më 21 janar. "Emilianon e kanë vrarë. Në këtë histori ka disa gjëra që nuk qëndrojnë, është diçka e bërë nxitimthi. Dua të kuptoj përse ka qenë i detyruar të hipë në atë avion. Ishte një lojtar i rëndësishëm dhe e lanë vetëm, pa pasur me vete asnjë përfaqësues", deklaron Matias Gati, kushëriri i sulmuesit argjentinas, që më pas shton. "Policia duhet të hetojë në pikat e errëta të historisë, duam drejtësi. Duhej të kishte udhëtuar në kushte të tjera. Nuk e dimë as nëse ai avion i kishte kushtet e duhura për të kaluar La Manshin. Askush nuk do të na e kthejë Emilianon pas, por nëse dikush ka gabuar, duhet të paguajë".

Ka luajtur vetëm 4 takime me fanellën bardhekuqe, por ka fituar menjëherë vendin e tij në formacion

# Taipi karikon: Asgjë nuk ka mbaruar, jemi Skënderbeu!

*Mesfushori shpreson te fitorja përballë Tiranës*



Jeton Selimi

Shqiptari nga Kosova, 22-vjeçari Shqipërim Taipi ka festuar ditëlindjen në Korçë, aty ku në 4 takimet që ka luajtur deri më tani, shihet si një lojtar me perspektive. Në prononcimin e tij për "RTSH sport", ka pohuar se ndjen shumë kënaqësi që luan me fanellën bardhekuqe: "Ndjenjë e veçantë që të luash me Skënderbeun, që ka qenë shumë vite edhe kampion. Nuk është e lehtë jo vetëm të luash, por edhe të jesh pjesë e Skënderbeut".

"Unë them se në Vlorë, skuadra nuk ishte në 100% dhe kjo ka qenë shkaku që nuk u morën 3 pikët. Shkuam për të marrë rezultat pozitiv, pasi vinim nga një fitore me Laçin në fushën tone, por fati nuk ishte me ne", - tha Taipi ndër të tjera pas humbjes me Flamurtarin.

Në fund, Taipi vuri në dukje se asgjë ka mbaruar dhe se ekipi duhet të japë më të mirën: "Kampionati është i gjatë, ne jemi futbollist profesionist dhe çdo ndeshje ka specifikën e vet. Ne duhet që të bëjmë më të mirën kudo ku luajmë. Ne dhe trajneri duhet që të bëhemi të fortë dhe të shohim përpara. Kemi respekt për të gjitha ekipet dhe është momenti që të fitojmë, luajmë në shtëpi dhe shpresoj që të gjithë të bëjmë më të mirën. Vijmë nga një humbje, por jemi profesionistë dhe duhet që të dalim nga kjo situatë. Me Tiranën kemi shansin që të marrim pikët maksimale".



**SKËNDERBEU-TIRANA**

Skënderbeu dhe Tirana luajnë mes tyre supersfidën e javës së 23-të në Superiore, por të dyja skuadrat kanë nga një mungesë të sigurt, dhe me peshë, në formacionet e tyre. Te Tirana kthehet për Skënderbeun Albi Doka, por bardheblutë humbin Erjon Hoxhallarin. Mbrojtësi i majtë për një ndërhyrje në pjesën e dytë ndaj Luftëtarit, çoi në katër numrin e kartonëve. Kjo do të thotë mungesë e mbrojtësit në takimin e radhës që luhet në Korçë me kampionët e vendit, Skënderbeun. Ndërkohë, në kampin korçar, Kristi Vangjeli humbet ndeshjen e radhës. Mbrojtësi u ndëshkua dje në Vlorë me kartonin e 4-t të verdhë dhe për pasojë skualifikohet për javën e 23-të. Gjatë këtyre ditëve i mbetet Orges Shehit që gjejë zëvendësuesin e tij. Dhe me mangësitë që kanë në mbrojtje, do të jetë një problem realisht i madh për korçarët ndërtimi i prapavijës.

**15 mijë dollarë për 10 muaj, paga e mbrojtësit**

## Albi Alla firmos në Kinë, pritet edhe Agustin Torasa

Albi Alla është zyrtarisht një lojtar i Janbian, klubit që militon në ligën e dytë kineze dhe që objektiv parësor ka ngjitjen në kategorinë e më të mirëve, ndërsa Agustin Torasa është fare pranë. Të dy lojtarët kanë lënë Flamurtarin ditën e djeshme për të siguruar sot kontrata të majme në Lindjen e Largët, me Allën që do të përfitojë rreth 150 mijë dollarë në 10 muajt e ardhshëm, ndërsa Torasa do të përfitojë rreth 50 mijë dollarë më shumë sesa Alla. Gjithçka ka ndodhur shumë shpejt. Alla dhe Torasa pasi janë njohur me ofertat, kanë vendosur të prishin kontratat me Flamurtarin duke qenë se pagat e prapambetura ja u lejojnë këtë mundësi në favor të tyre. Por as Flamurtari nuk është bërë pengesë, teksa drejtuesit vlonjatë kanë rënë dakord që t'u japin lejekalimet pasi dy futbollistët kanë hequr dorë nga pagat e prapambetura. Kështu, pasi Danilo Alveshit që ka firmosur dy ditë më parë në Kazakistan, Flamurtari humbet dy lojtarë të tjerë cilësorë nga formacioni bazë, me skuadrën vlonjate që është gjithnjë e më shumë në krizë totale.



**24-vjeçari do të luajë për Rigën**

## Prenga lë Kroacinë, firmos për dy vite në Letoni

Një aventurë e re për Herdi Prengën që lë futbollin ballkanas, për t'u transferuar në brigjet e Baltikut. Mesfushori kuqezi do ta vazhdojë karrierën në Letoni, ku firmosi një kontratë dy vjeçare me opsion rinovimi edhe për sezonin pasardhës, me skuadrën e Rigës, kampionen në fuqi të Letonisë. Në këtë mënyrë 24-vjeçari që tetorin e kaluar debutoi edhe më Kombëtaren Shqiptare në ndeshjen me Izraelin, lë pas kampionatin kroat ku dy sezonet e fundit ishte pjesë e Inter Zapresiç ndërsa më parë i përkiste Lokomotivës së Zagrebit, për të nisur një eksperiencë krejtësisht të re në karrierën e tij. Te Inter Zapresiç Prenga kishte regjistruar 13 prezenca në këtë sezon, duke rënë në sy të emisarëve të klubit letonez, që ia doli me sukses të fitojë shërbimet e mesfushorit, te i cili beson shumë. FC Riga është kampionia në fuqi e Letonisë, titull që synon të ruajë edhe në sezonin e ardhshëm, që në ish-Republikën Sovjetike nis pas pak javësh, në fillimin e muajit mars. Për Prengën, përtej aspektit ekonomik, në planin sportiv aventura e re ofron mundësinë për të luajtur në një skuadër që ka ambiciet maksimale në kampionatin vendas dhe njëkohësisht i jep mundësinë për të spikatur edhe në kompeticionet europiane.




www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE
Gazeta e gjithë shqiptarëve!
GSH
www.gsh.al
Kontakt: +355 68 40 63 842
Facebook: Gazeta Shqiptare
Intagram: gazetashqiptare.al
Twitter: Gazeta Shqiptare
E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
YouTube
Youtube: Gazeta Shqiptare
• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!
GAZETA SHQIPTARE
PENSIONET E PLEQERISË, ISSH: SI T'I LLOGARISNI
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al